



STRATEGJIA KOMBËTARE PËR MENAXHIMIN E QENVE ENDACAK

*Një qasje humane, efektive dhe e qëndrueshme
e kontrollit të popullsisë së qenve endacak
në Republikën e Kosovës*

Strategjia Kombëtare për menaxhimin e qenve endacak – Kopja I

Botues dhe redaktues kryesor:

Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve

Rr. Brahim Ademi, Mati 1, 10000, Prishtinë

Rr. Rexhep Luci, 9/8, 10000, Prishtinë

Tel: +383 (0) 49 444 237

www.animalrights-rks.org

Autorët:

Arif Aliu

Elza Ramadani

Dizajni:

Elena Totaj

© 2021 Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ndalohet shumëzimi dhe ribotimi i paautorizuar.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR MENAXHIMIN E QENVE ENDACAK

*Një qasje humane, efektive dhe e qëndrueshme e kontrollit
të popullsisë së qenve endacak në Republikën e Kosovës*



Tabela e Përmbajtjes

Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve.....	8
Hyrje	10
1. Rëndësia e strategjisë kombëtare për menaxhim të popullsisë së qenve endacak.....	10
2. Qentë në komunitet.....	12
2.1 Dinamika e qenve në komunitet	12
2.2 Benefitet dhe problemet	14
2.3 Vrasja nuk është zgjidhje.....	16
3. Metoda KSVL për menaxhim human të popullsisë së qenve endacak	17
4. Krijimi i grupit punues ndër-institucional	18
Konteksti kosovar dhe identifikimi i problemit	22
5. Zanafilla e problemit	23
6. Mungesa e bazës së mjaftueshme ligjore.....	25
7. Mungesa e edukimit dhe informimit.....	25
8. Çfarë është bërë deri më tani.....	26
Dizajnimi i strategjisë	28
9. Masat e një programi të suksesshëm.....	29
9.1 Identifikimi dhe regjistrimi i qenve me mikroçip.....	31
9.2 Edukimi në shkolla dhe shoqëri.....	32
9.3 Kontrolli i rreptë i mbarështimit dhe shitjes së qenve si kafshë shoqëruese	33
9.4 Subvencionimi i kastrimit/sterilizimit dhe vaksinimit të qenve me pronar.....	34
9.5 Kontrolli i riprodhimit - përmes metodës KSVL	35
9.6 Qendrat për trajtim të përkohshëm dhe qendrat e shpëtimit	36
9.7 Prezantimi i "Kujdestarëve të lagjes për qentë endacak"	40
9.8 Kontrolli i qasjes në resurse	41
10. Përgjegjësitë ligjore të institucioneve publike.....	42
10.1 Baza ligjore e konsultuar	43
10.2 Autorizimet dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) në raport me kontrollimin dhe menaxhimin e qenve endacak	44
10.3 Autorizimet dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në raport me kontrollimin dhe menaxhimin e qenve endacak	46
10.4 Autorizimet dhe përgjegjësitë e komunave në raport me kontrollimin dhe menaxhimin e qenve endacak	48
Zbatimi i programit të menaxhimit të popullsisë së qenve endacak	50
11. Plani i veprimit	51
Mirënjohjet	59



AKRONIMET

AGJ	<i>Afatgjatë</i>
AKSP	<i>Akademia e Kosovës për Siguri Publike</i>
AM	<i>Afatmesëm</i>
ASH	<i>Afatshkurtë</i>
ASHI	<i>Agjencia e Shoqërisë së Informacionit</i>
AUV	<i>Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë</i>
BE	<i>Bashkimi European</i>
FDK	<i>Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve</i>
GNIK	<i>Grupet ndër-institucionale komunale</i>
IRK	<i>Institucionet e Republikës së Kosovës</i>
KSVL	<i>Kap, Sterilizo, Vaksino, Lësho</i>
MAPL	<i>Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal</i>
MASHTI	<i>Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit</i>
MBPZHR	<i>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</i>
MMPQE	<i>Masat e Menaxhimit të Popullsisë së Qenve Endacak</i>
MPB	<i>Ministria e Punëve të Brendshme</i>
MSH	<i>Ministria e Shëndetësisë</i>
OSHC	<i>Organizatrat e Shoqërisë Civile</i>
PKGJ	<i>Programi Kombëtar Gjithëpërfshirës</i>
QTP	<i>Qendrat për Trajtim të Përkohshëm</i>
UA	<i>Udhëzim Administrativ</i>
ZKM	<i>Zyra e Kryeministrit</i>

FONDACIONI PËR TË DREJTAT E KAFSHËVE

Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve (shkurt: Për Kafshët) i themeluar në Prill 2018, fokusohet në aspektin ligjor dhe politik-bërës të përmirësimit të mirëqenies së kafshëve në Kosovë dhe përmirësimit të marrëdhënieve njeri-kafshë. Organizata është e përkushtuar ndaj të gjitha kafshëve, qofshin ato endacake, shoqëruese, në ferma, eksperimentale, sportive ose kafshët e egra.

Organizata përqëndrohet në angazhimin ligjor duke ekspozuar zbatimin e duhur të legjisllacionit aktual dhe duke ofruar sugjerime konkrete për përmirësimin e tij në mënyrë që të vendosen themele të qëndrueshme për rregullore dhe ligje më miqësore, etike dhe biocentrike të kafshëve, si dhe zbatimin e qëndrueshëm të tyre.

Që nga viti 2018, organizata ka realizuar më shumë se treqind (300) vizita monitorimi në qendra të ndryshme që mbajnë dhe trajtojnë kafshët endacake. Shumica e këtyre vizitave monitoruese janë kryer në qendrat e subjekteve veterinarë të kontraktuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për programin shtetëror të KSVL-së (kapje, sterilizim, vaksinim, lëshim). Për shkak të aktivitetit monitorues të organizatës, çdo punë joprofesionale dhe abuzive e veterinerëve të pakualifikuar është ekspozuar dhe raportuar më tej tek organet përgjegjëse, duke përfshirë edhe organet e drejtësisë.

Përveç fushës së monitorimit, FDK angazhohet edhe në fushën e mbrojtjes së drejtpërdrejtë ligjore të kafshëve (zbatimi i ligjit). Më konkretisht, organizata përpilon kallëzime penale kundër çdo abuzuesi të kafshëve në Kosovë. Organizata ka një avokat të punësuar i cili ofron shërbime juridike kundër abuzuesve të kafshëve në Kosovë si: përgatitja e parashtresave, padive, ankesave, kontratave, kërkesave të ndryshme juridike, kallëzimeve penale, etj. Deri më tani, organizata ka paraqitur dhjetëra kallëzime penale kundër akteve mizore siç janë praktikatat e përdorimit të qenve për luftëra.

Që nga themelimi, organizata ka punuar në edukimin dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve, OJQ-ve, individëve, etj., për zbatimin e drejtë të ligjeve dhe politikave dhe ka bërë propozime të projekteve dhe masave humane dhe të qëndrueshme për kafshët. Organizata ka propozuar projekte dhe masa humane dhe të qëndrueshme, për të ofruar koncepte strategjike mbi menaxhimin human dhe të qëndrueshëm të qenve endacak.

Përveç punës institucionale, monitoruese dhe ligjore, FDK-ja ka prani të madhe në TV, radio dhe rrjete sociale. Mediat i drejtohen FDK-së për çdo temë që lidhet me kafshët ose mirëqenien dhe të drejtat e kafshëve.

Një arritje e madhe e FDK-së, është ndryshimi i UA për regjistrimin e kafshëve shoqëruese. Udhëzimi i ri administrativ është nënshkruar nga Ministri i MBPZHR-së më 1 Mars 2021, dhe ka hyrë në fuqi më 10 Mars 2021.

Përveç rregullimit të obligimit të identifikimit dhe regjistrimit, së bashku me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, organizata ka punuar në ndryshimin e një udhëzimi tjetër administrativ i cili rregullon kompensimet financiare për shërbimet veterinarë për regjistrimin e kafshëve shoqëruese.

Përveç kësaj, FDK-ja në bashkëpunim me AUV-në, i ka dorëzuar MBPZHR-së për rishikim dhe miratim brenda këtij viti, një udhëzim të ri administrativ që rregullon mbarështimin dhe shitjen e kafshëve shoqëruese.

Aktet e mësipërme nënligjore përfaqësojnë shtyllat më të rëndësishme të menaxhimit të popullsisë së qenve endacak. Zbatimi i drejtë i këtyre akteve nënligjore, së bashku me masat e tjera të propozuara në këtë strategji, do të çojë në një reduktim human dhe të qëndrueshëm të numrit të qenve endacak në Kosovë.

Donatorët kryesorë të FDK-së përfshijnë: Fondacioni Stumme Brueder (Lichtenstein), PETA Germany, Fondacioni StrayCoco, LAV (Lega Anti-Vivisezione) dhe ATB (ATB-Associazione Trentino con i Balcani), Benito Mares - themelues dhe drejtor i "South Kosovo Dog and Cat Shelter" (një qytetar amerikan që ndihmon njerëzit dhe kafshët, që nga pas lufta në Kosovë).

HYRJE

1. RËNDËSIA E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MENAXHIM TË POPULLSISË SË QENVE ENDACAK

Ky dokument strategjik është përpiluar për organet qeveritare dhe organizatat ndërqeveritare të cilët janë të përfshira në menaxhimin e popullsisë së qenve endacak, fillimisht duke u fokusuar tek zvogëlimi i qëndrueshëm dhe human i numrit të qenve endacak si dhe në mbrojtjen e mirëqenies së qenve endacak në Republikën e Kosovës.

Kjo strategji po ashtu synon të udhëzojë edhe entitetet private, organizatat joqeveritare (OJQ) dhe entitetet tjera, si palë të interesuara në menaxhimin e popullsisë së qenve endacak, përmes metodave humane dhe efektive.

Kjo strategji shërben për të mbështetur zbatimin e projekteve dhe masave shtetërore dhe jo-shtetërore të menaxhimit të qëndrueshëm, efektiv dhe njerëzor të popullsisë së kafshëve endacake në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në njohuritë e shteteve më të zhvilluara dhe nga përvojat dhe të gjeturat e OJQ "Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve" nga puna e tyre

.....
1 KSVL – Kap, sterilizo, vaksino, lësho

në terren dhe nga takimet institucionale rreth kësaj tematike. Gjatë punës së FDK-së është zbuluar se programet shtetërore për reduktimin e shumimit të qenve në rrugë me anë të metodës KSVL¹, asnjëherë nuk kanë sjellur efektet e dëshiruara për shkak të menaxhimit jo të duhur dhe për shkak të mungesës së koordinimit ndër-institucional për masat e ndërmarra deri më tani, duke bërë që numri i qenve dhe kafshëve endacake në përgjithësi, të mos ulet në mënyrë efektive, të qëndrueshme dhe shpesh, as në mënyrë humane.

Kjo strategji përpiqet të shpjegojë gjendjen aktuale të situatës me qen endacak si dhe të propozojë rekomandime përbrenda një **Plani Kombëtar Gjithpërfshirës (PKGJ)**, i cili zbatohet përmes **Masave të Menaxhimit të Popullsisë së Qenve Endacak (MMPQE)** të cilat janë thelbësore për t'u zbatuar, në mënyrë që numri i qenve në rrugë të zvogëlohet dukshëm në pesë (5) vitet e ardhshme.

Është thelbësore që organet shtetërore ta konsiderojnë dhe trajtojnë fenomenin e rritjes së vazhdueshme të qenve endacak me shumë seriozitet institucional dhe të dedikojnë fonde të mjaftueshme për përmirësimin e dukshëm të situatës, deri në vitin 2026.

Nga shumë praktika të vendeve të zhvilluara të BE –së^{2,3}, përgjegjësia ligjore dhe ekzekutive për menaxhimin e duhur të popullsisë së qenve endacak i takon qeverisë lokale dhe qendrore, siç parashikohet nga legjislati në fuqi edhe në Kosovë. Subjektet jo-qeveritare dhe jofitimprurëse të mirëqenies së kafshëve nuk duhet të inkurajohen ose të përpiqen të marrin përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e popullsisë së qenve endacak, përveç përmes një marrëveshjeje kontraktuale, brenda mandatit të një institucioni përkatës, me fonde dhe burime të përshtatshme për të kryer punë efektive në menaxhimin e projekteve që ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe trajtimin ligjor dhe njerëzor të qenve endacak.

Megjithatë, OJQ-të e mirëqenies së kafshëve luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e çfarëdo mase institucionale, dhe për t'u siguruar që autoritetet kompetente në mënyrë të përgjegjshme i aplikojnë praktikat më të mira ligjore për menaxhimin e popullsisë së qenve endacak në vend.

Kjo strategji ofron një pasqyrë të qartë për kohën, përgjegjësitë institucionale, administrative dhe teknike, burimet dhe personelin e nevojshëm, me një plan real për të krijuar një sistem në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare dhe të BE-së, sa i përket trajtimit të kafshëve shoqëruese dhe qenve endacak.

Mungesa e të dhënave në këtë fushë, në Kosovë është më se e dukshme, gjë që vështirëson punën e kësaj natyre sepse deri më tani, nga asnjë organ shtetëror përgjegjës nuk është bërë ndonjë studim vlerësimi për situatën e qenve endacak në vend, më konkretisht numërimin e tyre, sëmundjet eventuale të kafshëve endacake, dhe raportet njeri-kafshë për të evituar incidentet potenciale. Në anën tjetër, në Kosovë dihet qartë zanafilla e problemit të prezencës së numrit të madh të qenve endacak (*shpjeguar në Kapitullin II, pika 5*) dhe në bazë të burimit të problemit, mund të ofrohen zgjidhjet më humane, efikase, dhe të qëndrueshme për zvogëlimin e numrit të qenve endacak në Kosovë.

Popullsia e qenve mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme ndërmjet dhe brenda vendeve dhe shteteve të ndryshme, duke u bazuar në situata të ndryshme të sjelljeve njerëzore dhe institucionale ndaj kafshëve dhe ndaj projekteve të menaxhimit të kafshëve shoqëruese. Kjo tregon që nuk mund të pretendohet të intervenohet me masa të vetme apo identike për secilin shtet, por gjithsesi vlen të theksohet se disa masa thelbësore për një program gjithëpërfshirës, gjithmonë duhet respektuar kur bëhet fjalë për menaxhimin e qëndrueshëm të numrit të qenve endacak.

Kjo strategji po ashtu do të sqarojë edhe përgjegjësitë ligjore të institucioneve relevante dhe koston financiare që implikohet, të cilën duhet ta mbulojë niveli qendror dhe lokal në mënyrë që të parandalohet dhe zvogëlohet shtimi dhe shumimi i qenve endacak në vendin tonë.

2 <https://dutchreview.com/culture/how-did-the-netherlands-manage-to-become-the-first-country-to-have-no-stray-dogs/>

3 <http://www.stray-afp.org/nl/wp-content/uploads/2012/09/WSPA-RSPCA-International-stray-control-practices-in-Europe-2006-2007.pdf>

2. QENTË NË KOMUNITET


Për më shumë se 10.000 vite, qentë kanë bashkëjetuar me njerëzit, duke ofruar shumë të mira për ta. Përkundër të mirave, mungesa e kontrollit të qenve si kafshë shoqëruese, mund të shkaktojë shqetësime në komunitet. Këto shqetësime përfshijnë rritjen e numrit të qenve endacak, gjë që rrezikon shëndetin dhe sigurinë publike, dhe mirëqenien e vet kafshëve që jetojnë në rrugë.

2.1 DINAMIKA E QENVE NË KOMUNITET

Dinamika e popullsisë së qenve endacak krijohet me nën-popullsi të ndryshme të qenve në rrugë, që bashkëveprojnë/riprodhohen dhe formojnë tërë popullsinë e qenve endacak. Kjo dinamikë merr parasysh proceset e braktisjeve, lindjeve, vdekjeve dhe riprodhimit për të kuptuar mënyrën se si qentë hyjnë dhe largohen nga kjo popullsi.

Siç mund të shihet në figurën e mëposhtme, qentë endacak përfundojnë në rrugë nga shtëpitë të cilat i kanë mbajtur dhe strehuar më parë. Qentë si kafshë shoqëruese (ang. 'companion animal' ose 'pet') zakonisht blihen nga dyqanet e kafshëve apo dhurohen nga ndonjë mik apo familjar. Qentë si kafshë shoqëruese, normalisht duhet të mbahen me përgjegjësi të plotë duke iu ofruar strehim të sigurtë, trajtim mjekësor veterinar dhe aktivitete ditore për t'iu plotësuar nevojat fiziologjike dhe psikike.

Dinamikat e popullimit të qenve në rrugë



Në Kosovë, është më së evidente që mënyrat e dobëta të mbajtjes së qenve si kafshë shoqëruese bëjnë që pastaj ata qen të përfundojnë në rrugë.

Mbajtjet e papërgjegjshme të qenve janë të shpjguara më poshtë:

1. *Qen të pa kastruar/sterilizuar që mbahen të lirë vetëm në oborr dhe nuk shëtisin asnjëherë jashtë shtëpisë;*
2. *Qen të pa kastruar/sterilizuar që mbahen të lirë në oborr dhe në rrugë (bredhin rrugëve); p.sh. qentë që ruajnë bagëtitë apo shumë qen që mbahen në fshatra;*
3. *Qen të pa kastruar/sterilizuar që mbahen të lidhur me zinxhir gjatë gjithë jetës së tyre;*
4. *Qen që mbahen në mënyrë të organizuar për t'i trajnuar për luftëra dhe agresivitet;*
5. *Qen që mbahen për mbarështim - të pakontrolluar dhe të paevidentuar;*

Nga mbajtja e kafshës shoqëruese në kushtet e cekura më lartë, bëhet mjaft aktual edhe vendimi i shumë personave që t'i braktisin qentë e tyre. Në anën tjetër, shumë familje kosovare të cilat mbajnë qen në shtëpitë e tyre, nuk posedojnë të ardhura financiare të mjaftueshme për të mbajtur një kafshë shtëpiake (qen) në mënyrë të përgjegjshme. Siç dihet, trajtimet veterinarë përmbajnë në vete një kosto e cila është e papërbalueshme për shumë mbajtës/pronar të qenve.

Për fat të keq, populli i Kosovës asnjëherë nuk ka marrë informata të duhura rreth mbajtjes së përgjegjshme të kafshëve shoqëruese, dhe si rezultat i kësaj, duke mos pasur parasysh sfidat që mund të paraqiten nga mbajtja e qenve si kafshë shoqëruese, shumë qytetarë vendosin t'i largojnë qentë nga shtëpitë e tyre ose t'i mbajnë ata për tërë jetën, të lidhur dhe në gjendje të keqe.

Mbështetja shtetërore për kastrimin dhe sterilizimin e qenve me pronar, do të ishte lehtësim për qytetarët dhe do të kishte më shumë qen të kastruar/sterilizuar - që edhe nëse potencialisht do të përfundonin në rrugë, nuk do të shumoheshin me qen të tjerë.

Shumë shpesh ndodh që edhe qentë që janë përdorur për luftëra të përfundojnë në rrugë, të braktisur. Mund të ndodhë që qeni jashtë territorit të tij nuk tregohet agresiv, por gjasat janë të mëdha që qentë që janë mësuar të jenë agresiv me njerëz dhe kafshë të tjera, të sulmojnë dhe të shkaktojnë probleme për komunitetin. Luftimi i fenomenit të rritjes dhe trajnimit të qenve për luftëra dhe agresivitet është **sfidë në vete dhe po ashtu kërkon vëmendjen e organeve të drejtësisë dhe institucioneve publike me shumë seriozitet dhe prioritet, në mënyrë që krimi i organizuar me qen të ndalojë sa më parë, ashtu siç parashihet edhe me nenin 346 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

2.2 BENEFITET DHE PROBLEMET

DEFINICIONI	PASOJAT	SHKAKU	DEFINICIONI
Sëmundjet specifike të kafshëve, sëmundjet zoonotike dhe parazitare	SHPËRNDARJA E SËMUNDJEVE	MUNGESA E INFORMATAVE	Mungesa e edukimit rreth mirëqenies së kafshëve, sjelljes së kafshëve, transmetimit të sëmundjeve, zoonozës dhe përgjegjësi siç janë vaksinimi dhe identifikimi
Trauma fizike dhe mendore për të afektuarit, kosto ekonomike për familjet dhe potencial për shpërndarje të sëmundjeve	KAFSHIMET	PROBLEMET ME QEVERISJE	Mungesa e fondeve qeveritare, mungesa e priorizimit të çështjes nga ana e qeverisë dhe një mosnjohje e koncepteve të menaxhimit të popullsisë së qenve
Të lehura, zhurmë, frikë, përceptim i papastërtisë, dhe telashe për njerëzit (p.sh. nevoja për të përdorur rrugë alternative)	SHQETËSIME	GJENDJA E RËNDË EKONOMIKE	Njerëzit nuk kanë mundësi financiare të kujdesen për kafshët
Ndotje dhe mbeturina, implikime shëndetësore për kafshët dhe njerëzit	KONTAMINIM	MBAJTJA E PAPËRGJEGJSHME E QENVE	Braktisja, lejimi i qenve të bredhin lirshëm, blerjet impulsive të qenve, dhënia e qenve si dhuratë, mungesa e identifikimit dhe regjistrimit, mungesa e trajtimeve të duhura veterinare
Përceptimi i rrugëve të papastra, frika nga kafshimet dhe mundësi më e madhe e shpërndarjes së mbeturinave	NUMËR NË RRITJE I QENVE NË RRUGË	MBARËSHTIMI I PAPËRGJEGJSHËM I QENVE	Mungesa e licencimit dhe kontrollit të mbarështuesve, mbarështues të papërgjegjshëm që nuk e respektojnë mirëqenien e kafshëve
Qen të sëmurë, të aksidentuar; Mizori dhe keqtrajtim ndaj qenve për shkak të perceptimit negativ për ta	MIRËQENIE E DOBËT E KAFSHËVE	MUNGESA E LEGJISLACIONIT	Mungesa e bazës së mjaftueshme ligjore dhe mungesa e zbatimit të legjislacionit aktual në fuqi
Rritje e numrit të kufomave të kafshëve në rrugë, rritje e vuajtjeve të kafshëve, kosto ekonomike për pronarët e veturave	AKSIDENTET NË TRAFIK	SHUMIMI I PAKONTROLLUAR I QENVE ME PRONAR QË BREDHIN LIRSHËM	Shumimi i qenve të cilëve iu mungon mbikëqyrja e duhur nga pronarët
Kostot ekonomike të lidhura me menaxhimin e popullsisë së qenve, trajtimin e sëmundjeve zoonotike, heqjen e kufomave, mbrojtjen e kafshëve të egra dhe bagëtive dhe dëmtimi i turizmit. Kostot politike që lidhen me dëmtimin e reputacionit për shkak të pranimit të trajtimit çnjerëzor të qenve.	PASOJAT PËR QEVERINË	DIS-PONUESHMËRIA E BURIMEVE TË SHUMTA	Teprica të shumta të ushqimeve, mungesa e menaxhimit të duhur të mbeturinave dhe njerëz që vullnetarisht ushqejnë kafshët e rrugës
		SHITJA ILEGALE DHE TRAFIKIMI I QENVE	Shitja e qenve nëpër dyqane të kafshëve (Pet Shops), importi i pakontrolluar i qenve, transporti ilegal i qenve
		MUNGESA E ANGAZHIMIT TË KOORDINUAR TË KOMUNITETIT VETERINAR	Dështimi i veterinerëve dhe autoriteteve për t'u angazhuar me komuna, veterinerë të sektorit privat dhe palët e interesit. Mungesa e furnizimeve dhe trajnimit të profesionistëve veteriner dhe teknikëve veterinar

SHQETËSIMET QË LIDHEN ME POPULLSINË E QENVE

DEFINICIONI	BENEFITET
Kosto të reduktuara të lidhura me trajtimet e kafshimit të qenve, kujdesin veterinar dhe shëndetësor, përfitimet e turizmit dhe uljen e kostove për shoferët. Kostot e reduktuara për shoferët janë për shkak të më pak aksidenteve rrugore si rezultat i më pak qenve në rrugë	BENEFITET EKONOMIKE
Reduktimi dhe eliminimi i sëmundjeve, zvogëlimi i numrit të rasteve të kafshimeve të qenve, rasteve të sjelljes agresive, lehjeve, ndotjeve dhe aksidenteve të trafikut rrugor dhe një rritje e tolerancës ndaj qenve	NUMËR I REDUKTUAR I QENVE NË RRUGË
Qen më të shëndetshëm dhe më të lumtur	MIRËQENIE MË E MIRË E KAFSHËVE
Përmirëson mirëqenien e kafshëve në komunitet	VETDIJËSIM MË I MADH
Një ndërgjegjësim i përmirësuar, mbajtja e përgjegjshme e qenve, menaxhimi i popullsisë së qenve, nevojat e qenve dhe parandalimi i kafshimeve	EDUKIMI I KOMUNITETIT
Menaxhimi i përmirësuar i mbeturinave dhe menaxhimi i produkteve të mbetjeve shtazore	AMBIENT MË I PASTËR
Komuniteti është i përfshirë po aq sa zyrtarët shtetërorë, duke siguruar përgjegjësi të përbashkët dhe një program të strukturuar mirë	GRUPET NDËR-INSTITUCIONALE E MBAJNË PROGRAMIN AKTIV
Reputacion i përmirësuar i qeverive lokale dhe qendrore	BENEFITET POLITIKE

MENAXHIMI I POPULLSISË SË QENVE

ZGJIDHJA	DEFINICIONI
MBAJTJA E PËRGJEGJSHME E QENVE	Promovimi i kujdesit shëndetësor për kafshët duke përfshirë vaksinimin, sterilizimin dhe heqjen e parazitëve, ushqimin e mirë, identifikimin dhe regjistrimin, socializimin, trajnimin, mbikëqyrjen, lojën dhe ushtrimet e rregullta
ZBATIMI I LEGJISLACIONIT NË FUQI	Ligjet kombëtare, komunale ose ndërkombëtare që marrin parasysh si në vijim: keqtrajtimin, neglizhencën, abuzimin, sigurinë e njerëzve, përgjegjësinë për qentë, shumimin, qentë endacak, braktisjen dhe dyqanet e kafshëve shoqëruese, tregjet dhe shitësit
ANGAZHIMI I QEVERISË	Kontributi financiar, staf i trajnuar dhe ngritja e programeve të menaxhimit të qenve në një prioritet të Qeverisë
EKSPOZIMI NË MEDIA	Ndërgjegjësim i përmirësuar i komunitetit për çështje të tilla si mbajtja e përgjegjshme e qenve, programet e menaxhimit të qenve dhe kontrolli i tërbimit dhe sëmundjeve të tjera
KUJDESTARËT E LAGJES	Angazhimi i kujdestarëve të lagjes për kafshët endacake do të rriste mirëqenien e kafshëve, do të ndikonte në përmirësimin e programeve të menaxhimit të qenve dhe do të ofronte zgjidhje të reja për problemet me qentë endacak
KONTROLLI I MBARËSHTIMIT	Kontrolli dhe licencimi i mbarështuesve, promovimi i adoptimeve dhe vendosja e standardeve për mbarështim
MENAXHIMI I STREHIMOREVE	Regjistrimi i strehimoreve dhe vendosja e standardeve minimale për strehimoret duke përfshirë sterilizimin, vaksinimin, eutanazinë, përmirësimin e mirëqenies së kafshëve dhe promovimin e adoptimeve
SHËRBIME ADEKUATE VETERINARE	Veterinerë të specializuar dhe me përvojë në trajtimin e kafshëve të vogla siç është qeni
QASJE E LIMITUAR NË MBETJET USHQIMORE	Menaxhim më i mirë mjedisor, duke përfshirë heqjen e mbeturinave, pastërtinë dhe asgjësimin e duhur të mbetjeve shtazore
GRUPI NDËR-INSTITUCIONAL KOMUNAL	Këtu do të përfshiheshin qeveritë lokale dhe qendrore, OJQ -të, komunitetet veterinare, organizatat ndërkombëtare, strehimoret dhe mediat
EDUKIMI PËR MIRËQENIEN E KAFSHËVE	I mbështetur nga OJQ-të, komuniteti veterinar dhe mediat, dhe i zbatuar në shkolla nga profesionistët e edukimit
PLANI I KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE ZOOTIKE	Plani i kontrollit të sëmundjeve zootike përfshin tërbimin, lëshmanjozën, ekinokokun dhe parazitët, dhe ndikon në siguri të shëndetit publik si dhe në mirëqenie më të mirë të kafshëve

2.3 VRASJA NUK ËSHTË ZGJIDHJE

Për të kontrolluar lehtë dhe shpejt popullsinë e qenve endacak, disa qeveri në të kaluarën kanë zgjedhur metodën e kontrollit përmes vrasjeve selektive, në mënyrë që të ulin numrin e qenve endacak në një numër të pranueshëm.⁴⁵

Këto masa shpesh janë ndërmarrë duke përdorur metoda çnjerëzore dhe duke shkaktuar vuajtje dhe vdekje të panevojshme të kafshëve.

Hulumtimet gjithashtu tregojnë se masat e vrasjes së qenve endacak, përveç që janë çnjerëzore, janë të shtrenjta dhe joefektive.⁶⁷ Përderisa numri i popullsisë së qenve pas vrasjes së organizuar mund të bie, numri i qenve endacak prapë do të rritet shpejt. Përderisa nuk ka fokus tek burimet e problemit, qentë e vrarë do të zëvendësohen me qen të tjerë endacak, të cilët do të adaptohen nëpër territoret e liruara nga qentë e vrarë.

Një efekt tjetër negativ që ka vrasja masive e qenve, është zvogëlimi i imunitetit të tufës ndaj sëmundjes së tërbimit, ku vrasja diskriminuese që ndodh, zakonisht përfshin edhe qen që janë në pronësi ose nën kujdesin e komunitetit, dhe që janë të shëndetshëm dhe të vaksinuar. Qentë e vrarë që ishin të imunizuar nga sëmundja e tërbimit, do të zëvendësohen me këlyshë të pavaksinuar dhe të patrajtuar⁸, duke rritur rrezikun e sëmundjeve zoonotike në njërën anë, dhe në anën tjetër, të zvogëlimit të imunitetit të tufës sa i përket sëmundjes së tërbimit, dhe në këtë mënyrë duke rrezikuar kështu edhe komunitetin.⁹

.....
4 Huffington Post (2014) Was the Romanian stray dog killing law based on false information? http://www.huffingtonpost.co.uk/rita-pal/romania-stray-dogs_b_5792862.html

5 Jakarta Post (2014) Stray dogs must be culled, Bali governor says. <http://www.thejakartapost.com/news/2014/06/27/stray-dogs-must-be-culled-bali-governor-says.html>

6 World Animal Protection (2013) Controlling rabies. One humane solution, three reasons why. http://www.worldanimalprotection.org/sites/default/files/int_files/controlling_rabies-one_humane_solution.pdf

7 Haesler, B., Gregory, N., Bennani, H., Gilbert, W., Fornace, K. & Rushton, J. (2012) Evaluation of rabies control in the province of Bali, Indonesia: A comprehensive framework to evaluate rabies control strategies taking into account economics, animal welfare, epidemiology, social acceptability and ethics. London, UK: Royal Veterinary College.

8 Cleaveland, S et al. (2014) The changing landscape of rabies epidemiology and control. *Journal of Veterinary Research*. 81(2) 8 pages. doi: 10.4102/ojvr.v81i2.731

9 World Animal Protection (2013) Controlling rabies. One humane solution, three reasons why. http://www.worldanimalprotection.org/sites/default/files/int_files/controlling_rabies-one_humane_solution.pdf

3. METODA KSVL PËR MENAXHIM HUMAN TË POPULLSISË SË QENVE ENDACAK

Metoda KSVL (ose anglisht CNVR: catch, neuter, vaccinate, release), shkurtesat e të cilës qëndrojnë për *K-kapja*, *S-sterilizimi*, *V-vaksinimi dhe L-lëshimi*, e cila parashihet edhe me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) 04/2017¹⁰, është njëra nga metodat më të suksesshme të kontrollimit dhe menaxhimit të qenve endacak sipas organizatave botërore si OBSH¹¹, OIE¹² dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Kafshëve Shoqëruese¹³.

'Kapja', tek metoda KSVL dhe sipas Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 04/2017, duhet të bëhet nga persona të kualifikuar (të trajnuar) që ta bëjnë zënien e qenve me mënyra me të cilat kafsha nuk lëndohet apo vëhet në stres, pa nevojë. Pas zënies, qeni endacak vendoset në makinën transportuese e cila duhet të përmbajë kushtet adekuate për transport të duhur të qenve endacak, pranë klinikës/ambulantës veterinare për t'u përgatitur për operacion. Pasi që qeni të transportohet në klinikën veterinare, ai futet në karantinë të klinikës, ku i bëhet një kontrollë e përgjithshme dhe diagnostifikohet nëse ka ndonjë sëmundje të rrezikshme ngjitesë për qentë e tjerë apo njerëzit.

Pas periudhës para operacionale, qeni futet nën anestezion dhe përgatitet për kastrim apo sterilizim.

Pas operacionit, qeni duhet të vendoset me kujdes për rehabilitim, në një boks/dhomë të përshtatshme ku mund të lëvizë lirshëm.

Lirimi i një qeni mashkull bëhet 3-5 ditë pas operacionit, qentë femra në varësi të operacionit. Ovariektomia¹⁴ me prerje të vogël shërohet shpejt dhe lirimi mund të bëhet brenda pesë (5) ditësh pas operacionit. Nëse është bërë histerektomi¹⁵, qeni ka nevojë për shërim deri në dhjetë (10) ditë. Rekomandohet trajnimi i veterinerëve në ovariektominë me prerje të vogël, e cila është e shpejtë, prerja është e vogël dhe shërohet më shpejt.

Në ndërkohë, qeni po ashtu vaksinohet kundër tërbimit, gjë që është ligjërisht e kërkuar në vendin tonë.

Para lëshimit, qenve endacak të trajtuar u vendoset një numër identifikimi (etiketë veshi) për të informuar qytetarët se qeni nuk mbarështohet dhe që është i vaksinuar kundër tërbimit. Qentë duhet të lirohen në të njëjtin vend ku kapen, dhe lëshimi duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë pas kapjes, sepse përndryshe territori i mëparshëm mund të pushtohet nga qen të rinj që çon në përleshje midis qenve.

Lirimi i qenit, saktësisht në vendin se ku është marrë është shumë i rëndësishëm, ngaqë qentë mësohen në një vend të caktuar dhe dinë ku të kërkojnë ushqim në lagjet ku janë rritur dhe po ashtu i njohin banorët përreth; kjo do të thotë që rreziku i sulmeve të tyre ndaj njerëzve është shumë i vogël, sepse janë të mësuar në një lagje apo vend të caktuar. Qentë janë të komunitetit, i takon edhe komunitetit që t'i trajtojë mirë, pa dhunë dhe me respekt.

10 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15166>

11 https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/61417/HO_ZOON_90.166.pdf?sequence=1&is-allowed=y

12 https://www.oie.int/fileadmin/Home/eng/Health_standards/tahc/current/chapitre_aw_stray_dog.pdf

13 <https://rm.coe.int/168007a67d>

14 <https://vcahospitals.com/know-your-pet/spaying-in-dogs>

15 *ibid.*

Nëse komuniteti i ushqen qentë, ata asnjëherë nuk do ta shohin njeriun si rival, por si mik që sjell ushqim dhe si një kafshë tjetër e besueshme për ta. Qentë, nuk e kanë rival natyror njeriun (si luani zebrën apo ujku delen). Çdo agresion ose sulm i mundshëm i qenve ndaj njerëzve ndodh vetëm për shkak të frikës së tyre dhe traumave që kanë përjetuar më parë nga vetë njerëzit, ose nga uria - atëherë uria dominon sjelljen e tyre.

Këtu mund të konkludojmë se projektet e KSVL-së dhe programet e tjera shtetërore, janë të suksesshme vetëm nëse qytetarët gjithashtu kontribuojnë me mirësinë dhe durimin e tyre dhe u lënë qenve të paktën ujë nëse jo ushqim pranë shtëpive të tyre.

Gjatë zbatimit të projekteve që synojnë të kontrollojnë riprodhimin e qenve endacak duke përdorur metodën KSVL, eutanazia¹⁶ do të jetë e nevojshme për qentë që vuajnë nga një sëmundje ose lëndim i pashërueshëm (sëmundje të listuara në Ligjin për Veterinarinë¹⁷) ose kanë sjellje agresive të pakthyeshme (Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve¹⁸) ose probleme të tjera që i pengojnë ata të adoptohen ose të kthehen në rrugë. Një program i suksesshëm i menaxhimit të popullsisë së qenve duhet të krijojë një situatë në të cilën eutanazia aplikohet në raste të rralla, ndërsa të gjitha kafshët e shëndetshme, nëse nuk adoptohen, kthehen në rrugë (pas kastrimit/sterilizimit dhe vaksinimit) për t'u bërë pjesë e komunitetit dhe nën kujdesin e komunitetit.

Eutanazia merret vetëm me simptomat dhe jo me burimet e problemit. Popullsia e qenve endacak nuk mund të menaxhohet përmes eutanazisë, kështu që eutanazia nuk duhet të përdoret kurrë si një masë e vetme dhe konstante.

Sa herë që ka nevojë për eutanazi (qen shumë agresivë dhe të pa përmirësueshëm ose shumë të sëmurë), duhet të sigurohet që vendimi të konstatohet nga një veteriner profesionist dhe të bëhet me metoda humane, si dhe të sigurohet që kafsha të humbasë vetëdijen dhe të vdesë pa iu shkaktuar vuajtje.

4. KRIJIMI I GRUPIT PUNUES NDËR-INSTITUCIONAL

Menaxhimi i popullsisë së qenve është një çështje shumëfaktoriale dhe kërkon bashkëpunim midis institucioneve të ndryshme publike por gjithsesi kërkon një subjekt institucional që të koordinojë të gjithë procesin e menaxhimit të popullsisë së qenve endacak.

Masat e Menaxhimit të Popullsisë së Qenve Endacak (MMPQE) janë programe shtetërore përbrenda PKGJ-së për të menaxhuar numrin e qenve endacak dhe për të parandaluar rritjen e vazhdueshme të numrit të tyre në rrugë.

16 <https://www.vet.cornell.edu/about-us/outreach/pet-loss-support-hotline/resources-grieving/facts-about-euthanasia/facts-about-euthanasia-small-animals>

17 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2476>

18 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2411>

MMPQE-të paraqesin udhëzime të qarta për institucionet publike sa i përket menaxhimit të qenve endacak, e po ashtu inkurajojnë dhe mbështesin sjelljet pozitive të njerëzve ndaj kafshëve, dhe ofrojnë kujdes për qentë e pakontrolluar dhe të patrajtuar në komunitet, kurse në anën tjetër, ofrojnë siguri për vet njerëzit, ndaj rreziqeve që mund të pësojnë nga qentë endacak. Këto masa kanë ndikim në dinamikën e popullsisë së qenve brenda komunitetit dhe të cilat shpjegohen më lartë (pika 2.1).

Masat në fjalë, duhet të zbatohen me disa parime të pathyeshme në mënyrë që të implementohen programe humane dhe të qëndrueshme. Qasja humane dhe planifikimi i qëndrueshëm janë dy parimet themelore për të bërë zgjidhje afatgjate dhe efektive për komunitetin dhe po ashtu për vet qentë e rrugës si pjesë e komunitetit.

Për zbatimin e MMPQE-ve dhe qëndrueshmërinë e tyre, Qeveria e Kosovës duhet t'i mbështesë të gjithë akterët e nivelit lokal dhe po ashtu duhet të angazhojë disa institucione të nivelit qendror si zbatues dhe vëzhgues të të gjithë ecurisë.

Krijimi i '**Grupeve Ndër-Institucionale Komunale (GNIK)**' në çdo komunë do të shërbente si mekanizëm i fuqishëm, në mënyrë që masat e propozuara në këtë strategji, të zbatohen me seriozitet dhe efikasitet, nga të gjitha palët e mandatuara. GNIK raportojnë tek grupi ndërinstitucional, i cili udhëhiqet nga Qeveria e Kosovës.

GNIK-të formohen nga entitetet lokale publike apo edhe private të cilat bashkëveprojnë për t'i përmbushur obligimet ligjore dhe kontraktuale të të gjitha palëve të përfshira me një **plan kohor, plan veprimi** dhe duke respektuar **indiktorët e PKGJ-së**.

Palë të interesit konsiderohen entitetet e listuara më poshtë:

- *Pushteti lokal/komunat - drejtoria e bujqësisë, arsimit, shëndetësisë, institucionet e sigurisë, informimit, inspektorët dhe zyrtarët policor*
- *Komuniteti veterinar - inspektorët veterinar, shoqatat profesionale veterinare, grupet joformale veterinare*
- *Komuniteti akademik me përvojë përkatëse - d.m.th., ekspertë të sjelljes së kafshëve, doktorë të veterinarisë, ekspertë të sociologjisë, ekologjisë dhe epidemiologjisë*
- *Komuniteti i OJQ-ve - lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për mirëqenien e kafshëve, të drejtat e kafshëve dhe shëndetin publik*
- *Mediat kombëtare dhe lokale - për edukim dhe vetdijësim të shoqërisë dhe promovim të masave lokale dhe qendrore për menaxhim të popullsisë së qenve endacak*
- *Komuniteti lokal - banorët e lagjeve, përfshirë pronarët e qenve*

Qeveria e Kosovës është një ndër akterët më të rëndësishëm për mbikëqyrjen e procesit, por niveli lokal është shumë i rëndësishëm për zbatimin e mirëfilltë dhe efikas të të gjithë strategjisë. Për më tepër, si hallkë më e gjërë e akterëve, përveç entiteteve të listuara më lartë, po ashtu kanë rëndësi:

- *Ligjvënësit: departamentet përkatëse të ministrive, për të shkruar, aprovuar dhe zbatuar legjislacionin në fuqi, sa i përket mbrojtjes së mirëqenies së kafshëve dhe çdo fushë që ndërlidhet me këtë aspekt*
- *Ekzekutuesit/zbatuesit e legjislacionit (inspektorët, policia, prokurorët) - ka rëndësi të madhe zbatimi i menjëhershëm i politikave, ligjeve dhe rregulloreve për mirëqenien e kafshëve, kontrolli i qenve me pronar dhe zbatimi i masave të menaxhimit të popullsisë së qenve*
- *Edukatorët: në shkolla dhe universitete - komuniteti duhet të jetë i informuar dhe i vet-dijësuar sa i përket raporteve njeri-kafshë, të kuptojë mirë rolin e tij që të ndihmojë në situatën e qenve të pastrehë dhe asesi të ndërmarrë veprime jashtëligjore dhe jo etike, siç është helmimi apo vrasja e kafshëve të rrugës*

Grupet ndër-institucionale duhet të formohen nga të gjithë akterët si më lartë, apo edhe akterë të tjerë shtesë, siç mund të jetë edhe sektori privat ekonomik. Mbledhjet e grupeve në fjalë parashihet të mbahen çdo tre muaj, për të raportuar mbi situatën e qenve endacak.

Gjithsesi vlen të theksohet se GNIK nuk ka efektin e dëshiruar nëse nuk përbëhet parimisht nga institucionet publike dhe pastaj të shtohen apo ftohen edhe akterë të tjerë të rëndësishëm, siç janë organizatat e shoqërisë civile.

Në kapitullin e III, pika 10, do të shpjegohen në detaje përgjegjësitë ligjore të institucioneve publike në Kosovë, sa i përket menaxhimit të popullsisë së qenve endacak.



02

*KONTEKSTI KOSOVAR
DHE IDENTIFIKIMI
I PROBLEMIT*

Jo aq ndryshe nga problemet e tjera politike, ekonomike dhe sociale me të cilat përballlet shteti i Kosovës, qëndron edhe situata e mirëqenies së kafshëve.

Numri i madh i qenve endacak në Kosovë, tregon që vet kafshët që jetojnë në rrugë, po ashtu janë të rrezikuara nga shumë faktorë që bëjnë që t'iu cenohet mirëqenia. Qentë endacak janë viktima të braktisjeve nga njerëzit, dhe janë vazhdimisht të rrezikuar nga keqtrajtimet, moti ekstrem, mungesa e ushqimit dhe ujit, mungesa e trajtimit të sëmundjeve, aksidentet në rrugë dhe shumë probleme të tjera.

Deri më tani, janë financuar me dhjetëra projekte të KSVL-së (komunale dhe qendrore) me qëllim të menaxhimit të popullsisë së qenve endacak. Nga rezultatet e këtyre projekteve dhe situata aktuale, mund të vijmë në përfundim që projektet e KSVL-së (masat e deritanishme) nuk janë zbatuar në plotësi dhe me profesionalizëm, kurse masat e tjera për zgjidhje afatgjate të këtij problemi nuk janë marrë fare parasysh - vetdijësimi i shoqërisë, edukimi në shkolla, regjistrimi i qenve me pronar dhe kontrolli i mbarështuesve të qenve.

Ashtu siç është thënë edhe më lartë, gjetja e zgjidhjes më efektive dhe të qëndrueshme të zvogëlimit të numrit të qenve endacak në rrugë dhe parandalimit të shtimit dhe shumimit të tyre, mund të bëhet vetëm nëse identifikohen dhe analizohen burimet kyçe të problematikës së qenve endacak nga institucionet përgjegjëse.

5. ZANAFILLA E PROBLEMIT

Institucionet e mandatuara për trajtimin e problemeve me qen endacak, fatkeqësisht nuk kanë të dhëna të regjistruara në lidhje me ndonjë analizë, studim ose hulumtim specifik kombëtar të bërë në lidhje me situatën e kafshëve të rrugës në Kosovë, i cili do të mund të kontribuonte me një numër të saktë ose fakte empirike mbi burimet kryesore të shtimit të qenve në rrugë.

Parregullsitë dhe problemet kryesore mund të vërehen nga angazhimi i dobët i të gjithë aktorëve politik të përfshirë deri më tani, por edhe nga mungesa e madhe e dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore për të rregulluar mbajtjen e përgjegjshme të qenve si kafshë shoqëruese dhe sanksionimin e braktisjes së kafshëve në rrugë dhe shkeljeve të tjera ligjore ndaj kafshëve shoqëruese apo edhe kafshëve endacake.



Pavarësisht se nuk ekzistojnë të dhëna empirike, burimet kryesore të qenve endacak në Kosovë identifikohen lehtë dhe janë të përshkruara në vijim:

1. *Braktisja e qenve dhe këlyshave të pa dëshiruar, nga shumë pronarë¹⁹,*
2. *Shumimi dhe shitja e pakontrolluar nga mbarështuesit e pa regjistruar dhe pa licencuar,*
3. *Importi jashtëligjor i kafshëve shoqëruese, dhe*
4. *Riprodhimi i vazhdueshëm i qenve të pa kastruar/sterilizuar në rrugë.*

Problemet e kaq shumë braktisjeve të kafshëve në Kosovë ekzistojnë për shkak të mungesës së një strukture shtetërore të regjistrimit të kafshëve shoqëruese deri më tani. Kjo konfirmohet gjithashtu nga raporti vjetor i Komisionit Evropian (Kosovo Report 2020)²⁰, i cili thotë se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk ndërmerr dhe as nuk miraton të gjitha masat e nevojshme për identifikimin dhe regjistrimin e të gjitha kafshëve në territorin e Kosovës.

Duke regjistruar të gjitha kafshët shoqëruese në Kosovë, do të hapet rrugë për të kontrolluar situatën e braktisjes së qenve si kafshë shoqëruese përmes sanksionimit të individëve që braktisin kafshët e tyre shoqëruese në rrugë, monitorimit të mbarështuesve dhe kontrollit të importit nga shtetet tjera. Përveç kësaj, me identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve shoqëruese, ato do të mbrohen më mirë nga institucionet shtetërore, si anëtarë të rëndësishëm të shoqërisë sonë.

Në anën tjetër, është e rëndësishme të theksohet që mungon një infrastrukturë shtetërore e strehimit të kafshëve shoqëruese që potencialisht do të përfundonin të braktisura në rrugë. Strehimi i qenve të pa dëshiruar do të funksiononte vetëm nëse do reduktohej numri i qenve endacak nga braktisjet e shumta dhe blerjet e çrregulluara dhe të pa përgjegjshme të kafshëve shoqëruese nga shumë njerëz.

Duke marrë parasysh mundësinë e lehtë të blerjes së kafshëve shoqëruese (qofshin ato edhe të kontrabanduara nga vendet e tjera), dhe nga mungesa e kontrollit/inspektimit të këtyre aktiviteteve jashtëligjore, braktisja e kafshëve shoqëruese pastaj bëhet e paevitueshme.

Po ashtu, një problem tjetër i qartë është fakti se në kurrikulën shkollore të të gjitha niveleve në Kosovë, mungojnë mësimet për mirëqenien e kafshëve dhe mbajtjen e tyre me përgjegjësi. Për më tepër, shteti nuk ka rregulluar kurrë me akte nënligjore, ofrimin e trajnimit për pronarët e mundshëm të kafshëve shoqëruese, as nuk ka organizuar ndonjëherë ndonjë fushatë informative, edhe pse ishte ndarë një buxhet për këtë qëllim dhe në fakt një kompani jokompetente për kryerjen e këtij shërbimi ishte e kontraktuar.²¹ Rrjedhimisht, si rezultat i kësaj të fundit, shumica e pronarëve të kafshëve shoqëruese kanë pak ose nuk kanë fare informata se si të kujdesen për një kafshë në një mënyrë që respekton plotësisht mirëqenien e tyre.

19 <https://www.youtube.com/watch?v=YTA9v9L61os&t=172s>

20 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

21 MALA FARM - Unique Identifier Number: 811295197

6. MUNGESA E BAZËS SË MJAFTUESHME LIGJORE

Edhe pse Ligji Nr. 02/L-10 për Përkujdesjen ndaj Kafshëve²², rregullon "mirëmbajtjen, kujdesin, strehimin, mbarështimin, transportimin dhe çështje të tjera që lidhen me kujdesin për kafshët", zbatimi i këtij ligji ende nuk vihet në praktikë. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të përmendet se legjislacioni aktual për mirëqenien e kafshëve është shumë sipërfaqësor dhe nuk rregullon plotësisht kushtet e mbajtjes së kafshëve në mënyrë që të respektohet mirëqenia e tyre nga njerëzit që mbajnë kafshë. Rregullimi i mbajtjes së kafshëve kontribuon drejtpërdrejt në mirëqenien e kafshëve, shëndetin e njeriut dhe po ashtu edhe në uljen e numrit të madh të qenve endacak në vend.

Duke i pasur parasysh katër burimet e identifikuar të rritjes së popullsisë së qenve endacak (pika 5), është më se e nevojshme dhe urgjente që të fillohet me ndryshimet dhe plotësimet e akteve ligjore dhe nënligjore, në mënyrë që trajtimi i çështjes së qenve endacak të përcillet me masa të qëndrueshme, efektive dhe humane.

Sa i përket ndryshimit të akteve nënligjore, një arritje e madhe është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ (MBPRZH) 02/2018 - për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve shoqëruese²³.

Pas një pune disa muajshe të AUV-së, Fondacionit për të Drejtat e Kafshëve dhe MBPZHR-së, Udhëzimi Administrativ u nënshkrua nga ish-Ministri i MBPZHR-së, z. Besian Mustafa, me 1 mars 2021, dhe ka hyrë në fuqi më 10 mars 2021. Udhëzimi i vjetër administrativ i krijuar në 2018 nga AUV, ishte i fokusuar në aspektet teknike të regjistrimit dhe nuk rregullonte detyrimet e pronarëve për të regjistruar qentë si kafshë shoqëruese, në një regjistër shtetëror.

Përveç regjistrimit të qenve si kafshë shoqëruese, po ashtu duhet të aprovohet edhe një udhëzim administrativ që rregullon mbarështimin e kafshëve shoqëruese dhe shitjen e tyre në Kosovë. Deri më tani, AUV nuk posedon asnjë regjistër të dyqaneve të kafshëve (Pet Shop-eve) apo të veterinerëve që shesin kafshë shoqëruese të mbarështuara brenda apo jashtë Kosovës.

7. MUNGESA E EDUKIMIT DHE INFORMIMIT

Deri më tani, nuk ka pasur asnjë kampanjë informuese të organizuar nga ndonjë institucion i vendit në lidhje me informimin e qytetarëve sa i përket mirëqenies së kafshëve, mbajtjes së përgjegjshme të kafshëve dhe parandalimit të braktisjes së tyre, e as kampanja informuese rreth problematikës së qenve endacak dhe sjelljes së qytetarëve karshi kësaj situate.

Në vitin 2018, AUV ka kontraktuar me tender publik në shumë prej 111,000 Eurove, një kompani jokompetente, për të bërë vetdijësimin dhe anketimin e qytetarëve sa i përket qenve endacak, dhe informimin e qytetarëve rreth projekteve shtetërore për zvogëlimin e numrit të qenve në rrugë.

22 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2471>

23 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=37624>

Kompania e kontraktuar (Mala Farm – NUI: 811295197), nuk ka bërë asnjë anketim dhe asnjë program vetdijësues për qytetarët e Kosovës gjatë kohëzgjatjes së projektit (2018-2020).

Projektet e KSVL-së dhe projektet e ndërgjegjësimit të qytetarëve kanë ekzistuar gjithmonë në letër, por puna dhe rezultatet nuk shihen askund. Nëse kontratat shtetërore vazhdojnë të jepen në mënyrë sipërfaqësore, pa kërkuar punë konkrete, të realizueshme dhe të matshme, nuk do të ketë përmirësim të situatës së qenve endacakë në Kosovë në të ardhmen e afërt.

Ndërgjegjësimi i qytetarëve nuk është konsideruar si diçka e rëndësishme për institucionet e Kosovës. Sipas një studimi të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)²⁴, është gjetur se gjatë periudhës tri vjeçare 2016-2018, më shumë se gjysma e qytetarëve i kanë përceptuar qentë endacak si kërcënim për sigurinë publike. Në vitin 2016, 55 % të qytetarëve i përceptonin qentë endacak si kërcënim për sigurinë e tyre personale, ndërsa në vitin 2017 numri u rrit në 63%. Megjithatë, në vitin 2018, përqindja u ul në 59%.

Siç është thënë më lartë, gjatë vitit 2018 ishte në zbatim projekti shtetëror për kastrim, sterilizim dhe vaksinim, andaj QKSS, në raportin e saj supozon që për shkak të kësaj edhe ka pasur rënie në përceptimin e qytetarëve kundrejt rrezikut së qenve endacak për shoqërinë, por përqindja nga vitit 2017 në 2018, është shumë e vogël. QKSS thekson qartë se projektet si KSVL të kombinuara me ngritjen e vetëdijes, janë të rëndësishme për të kontrolluar numrin e qenve endacak dhe përceptimet publike për ta.

“Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve” në Kosovë, ka realizuar disa aktivitete monitoruese dhe ka vëzhguar punën e veterinerëve në programin shtetëror të menaxhuar nga AUV, për sterilizimin dhe vaksinimin e qenve endacak (me metodën KSVL) në vitin 2018 dhe në vitin 2020. Për të njëjtën çështje dhe çështje të tjera, organizata është përpjekur të krijojë një bashkëpunim institucional, për të zbatuar projektet aktive në atë kohë dhe për të promovuar punën e qëndrueshme që kishte të bëjë me menaxhimin e qenve endacak.

Monitorimet e punës së KSVL-së kanë ofruar pasqyrë të qartë të ecurisë së punës, trajtimit të qenve përgjatë projekteve dhe parregullsitë dhe mangësitë që projektet shtetërore kishin dhe të cilat edhe sot vazhdojnë t’i kenë.

8. ÇFARË ËSHTË BËRË DERI MË TANI

Metoda KSVL ishte përdorur gjatë projekteve shtetërore në Kosovë, në 2018²⁵ dhe në 2020²⁶, dhe po ashtu në nivel komunal nga viti 2019. Pëndryshe, Komuna e Prishtinës, ka pasur projekte aktive të KSVL-së qysh nga viti 2014 edhe pse me shumë mangësi dhe parregullsi në të gjitha proceset e projekteve.

Mund të konsiderohet përparësi e madhe që Kosova aplikon këtë metodë dhe jo vrasjen e organizuar institucionale të qenve endacak, siç ka ndodhur para vitit 2017. Do të thotë, Udhëzimi administrativ (MBPZHR) 04/2017²⁷, përfshin metodën KSVL si metodën më humane dhe efektive për uljen e numrit të qenve endacak në Kosovë.

24 http://www.qkss.org/repository/docs/BKS_Sfidat_e_sigurise_publike_ne_Kosove_15030.pdf

25 Numri i prokurimit: 40800-18-1064-2-1-5

26 Numri i prokurimit: 40800-19-6574-2-1-5

27 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15166>

Vlen të theksohet që kjo metodë nuk ka efekt nëse në anën tjetër nuk zbatohen edhe masat e tjera përcjellëse dhe të qëndrueshme siç është parandalimi i braktisjeve duke regjistruar të gjithë qentë si kafshë shoqëruese në Kosovë dhe duke kontrolluar mbarështimin e tyre. Edhe nëse kastrohen/sterilizohen mijëra qen çdo vit, por braktisjet e qenve të pasterilizuar me pronar nuk ndalen, programet shtetërore të KSVL-së nuk do të ndërpriten kurrë dhe qen endacak do të ketë vazhdimisht. Ulja e numrit të tyre në rrugë, arrihet vetëm me një qasje institucionale strategjike dhe të qëndrueshme.

Përveç aspekteve të cekura më lartë, për të pasur sukses projektet e KSVL-së, projektet e tilla nuk duhet të ndalen përgjatë gjithë vitit dhe duhet të punohet në të gjitha komunat paralelisht në mënyrë që të kastrohen dhe sterilizohen sa më shumë qen të cilët braktisen në rrugë, dhe për të kastruar dhe sterilizuar qentë të cilët ishin këlyshë para një periudhe paraprahe kohore.

Në të kaluarën, në projektet shtetërore, shumica e veterinerëve nuk i kishin lëshuar qentë në të njëjtat vende ku ishin kapur për sterilizim. Kjo praktikë negative ka krijuar panik për shumë njerëz kur qentë e rinj janë prezantuar në lagjet e tyre. Gjithashtu, kjo praktikë mund të shkaktojë edhe rreziqe të sulmeve të qenve ndaj njerëzve nga frika e një territori të ri për ta. Qentë lidhen me një territor dhe ndryshimi i këtij të fundit mund të sjellë trauma për qentë dhe incidente midis njerëzve dhe qenve.

Një e metë tjetër e projekteve shtetërore të vitit 2018 dhe 2020, ka të bëjë kontraktimin e veterinerëve për të kryer shërbimet e KSVL-së. Shumica e veterinerëve të kontraktuar nuk ishin të specializuar në kirurgjinë e kafshëve të vogla siç është qeni apo macja. Nga përvoja e mangët e shumë veterinerëve në trajtimin mjekësor të qenve, ishin paraqitur edhe shumë probleme gjatë kryerjes së punës nga disa subjekteve veterinare përgjatë projekteve shtetërore të KSVL-së.



03



*DIZAJNIMI
I STRATEGJISË*

9. MASAT E NJË PROGRAMI TË SUKSESSHËM

Një gamë e masave duhet të merren parasysh për t'u realizuar një program i suksesshëm dhe efektiv i menaxhimit të popullsisë së qenve endacak në Kosovë. Këto masa të rëndësishme janë:

1. Identifikimi dhe regjistrimi i qenve si kafshë shoqëruese në tërë Republikën e Kosovës
2. Edukimi në shkolla dhe vetdijësimi i shoqërisë
3. Kontrolli i rreptë i mbarështimit dhe shitjes së qenve
4. Subvencionimi i kastrimit dhe sterilizimit të qenve me pronar
5. Kontrolli i vazhdueshëm i riprodhimit të qenve në rrugë përmes metodës KSVL
6. Qendrat për Trajtim të Përkohshëm (QTP) dhe qendrat e shpëtimit
7. Prezantimi i 'kujdestarëve të lagjes për kafshët endacake'
8. Kontrolli i qasjes në resurse

Akterët e përfshirë duhet të përshtaten me konceptin e **grupeve ndër-institucionale** dhe duhet të angazhohen, koordinohen dhe të konsultohen gjatë tërë kohës mes vete, për zbatimin e **PK-GJ**-së të strategjisë. Këto grupe do të jenë përgjegjëse për mbarëvajtjen e punëve (shiko pikën 4). Ato duhet gjithashtu të jenë të përfshira në dhënien e rekomandimeve për t'u përmirësuar programi në rast nevojë. Problemet dhe dështimet duhet të shihen si mundësi për të përmirësuar programin.

BAZAT E NJË PROGRAMI TË SUKSESSHËM TË MENAXHIMIT TË POPULLSISË SË QENVE ENDACAK



Promovimi i mbajtjes
së përgjegjshme



Forcimi i kapaciteteve
profesionale



Kontrolli i riprodhimit
përmes metodës KSVL



Subvencionimi i shërbimeve
veterinare



Qendrat për trajtim
të përkohshëm dhe
qendrat e shpëtimit



Identifikimi
dhe regjistrimi



Kontrolli i rreptë
i mbarështuesve dhe
shitjes së qenve



Edukimi në shkolla
dhe shoqëri



Kontrolli i qasjes
në resurse



Raporte pozitive njeri - qen

Legjislacioni
dhe Zbatimi

Grupi
ndër-institucional
komunal

Qëndrueshmëria
financiare dhe
partneritetet

Angazhimi
i komunitetit

9.1 IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI I QENVE ME MIKROÇIP

Mënyra më efektive për të lidhur qartë një pronar me qenin e tij/saj shoqëruese është identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve në një regjistër shtetëror të kafshëve dhe kontrolli i vazhdueshëm i regjistrimit nga inspektorët ose policia. Kjo do të nxisë ndjenjën e përgjegjësisë nga ana e pronarëve pasi kafsha bëhet e identifikueshme si e tij/saj dhe bën të mundur që institucionet e zbatimit të ligjit të gjurmojnë pronarët e papërgjegjshëm të qenve.

Identifikimi dhe regjistrimi është një mjet i rëndësishëm për ri-bashkimin e kafshëve të humbura me pronarët e tyre dhe po ashtu paraqet një themel të fortë për të zbatuar legjislacionin në fuqi, përfshirë legjislacionin kundër braktisjes së kafshëve dhe vaksinimet e detyrueshme kundër tërbimit.

Në rastin e Kosovës, ku një numër i madh i qenve duhet regjistruar dhe identifikuar, identifikimi me mikroçip aktualisht ofron opsionin më të mirë pasi që kombinimi i numrave në mikroçip është i mjaftueshëm për të identifikuar të gjithë qentë, ndërsa gabimet njerëzore (vendosja dhe leximi i gabuar i numrave) ka më pak gjasa të ndodhin pasi që për të lexuar mikroçipin përdoret skaneri digjital.

Mikroçipi gjithashtu ka avantazhin e përdorimit të një standardi global, pra edhe nëse kafshët lëvizin nga një shtet në shtet tjetër, mund të identifikohen lehtë.

Është shumë e rëndësishme që informatat e regjistrimit dhe identifikimit të ruhen në një regjistër qëndror shtetëror, i cili është i qasshëm për të gjitha palët relevante (p.sh. veterinerët, policia, inspektorët, drejtoritë për mirëqenie të kafshëve, etj.) Regjistrimi përmes mikroçipit do të funksionojë në mënyrë efektive vetëm nëse bëhen kontrolla dhe inspektime të vazhdueshme.

Po ashtu për këtë të fundit, kërkohet mbështetja dhe angazhimi i qeverisë qëndrore për t'u siguruar përdorimi i një sistemi të vetëm të unifikuar.

Përveç asaj që është thënë më lartë, me regjistrimin e pronarit të kafshës dhe vet kafshës shoqëruese, mund të sanksionohen braktisjet e kafshëve në mënyrë që të dekurajohet blerja e shfrenuar dhe e pa menduar e kafshëve shoqëruese.

Sipas Udhëzimit Administrativ 02/2021²⁸ për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve shoqëruese, të gjithë pronarët e qenve, duhet t'i identifikojnë me mikroçip dhe regjistrojnë qentë e tyre. Së bashku me regjistrim, UA parasheh që një pasaportë e unifikuar kombëtare e kafshëve shoqëruese të lëshohet nga AUV. Deri më tani, subjektet veterinarë përdornin formatin e tyre të pasaportave të kafshëve shoqëruese; një gjë e tillë nuk lejohet më. Që nga gushti i vitit 2021, AUV ka lëshuar një pasaportë shtetërore për kafshët shoqëruese falë Fondacionit "StrayCoCo" që ka mbështetur AUV-në për të hartuar dhe printuar 5000 kopjet e para të pasaportës së unifikuar të kafshëve shoqëruese.

.....
²⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=37624>

Siç u tha më parë, kjo pasaportë është pasaporta zyrtare e kafshëve shoqëruese e Republikës së Kosovës dhe duhet të përdoret nga të gjithë subjektet veterinare.

AUV është po ashtu në fazë të përditësimit të regjistrimit aktual të regjistrimit të kafshëve. Përditësimet softuerike të regjistrimit aktual kanë të bëjnë me shtimin e një komponenti softuerik për regjistrimin e qenve si kafshë shoqëruese. Këtë fazë e ka financuar organizata "Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve" nëpërmjet donatorit kryesor "StrayCoco" dhe Kompanisë "Smart Bits", e cila po ashtu është e angazhuar që ta bëjnë programimin e komponentit shtesë tek regjistri aktual i të dhënave të kafshëve në Kosovë.

Pasi që përditësimi i regjistrimit qëndror të ketë përfunduar, AUV duhet të bëjë kontraktimin apo autorizimin e veterinerëve, që ta fillojnë konkretisht procesin e identifikimit dhe regjistrimit të qenve si kafshë shoqëruese.

9.2 EDUKIMI NË SHKOLLA DHE SHOQËRI

Edukimi është një nga elementet më të rëndësishme të një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj menaxhimit të popullsisë së qenve endacak, pasi që sjellja njerëzore është një faktor me ndikim jashtëzakonisht të madh në dinamikën e popullsisë së qenve. Në përgjithësi, edukimi duhet të inkurajojë një përgjegjësi më të madhe të pronarëve të qenve, dhe kujdes për mirëqenie më të madhe të kafshëve individuale.

Vlen të theksohet se në faza të ndryshme të edukimit dhe ndërgjegjësimit, është e rëndësishme të theksohen tematika të ndryshme, që përfshijnë përzgjedhjen dhe kujdesi ndaj qenve; pritjet reale për mbajtjen e qenve, promovimin e rëndësisë së trajtimeve veterinare për parandalimin e sëmundjeve; promovimin e njohurive të përgjithshme për sjelljet normale dhe jonormale të qenve, parandalimin e kafshimit dhe përgjegjësitë ligjore që pronarët kanë për kafshët e tyre.

Gjithsesi, disa çështje duhet të merren parasysh kur zbatohen programet edukative:

a. *Iniciativat e edukimit duhet të zhvillohen në koordinim me autoritetet lokale të arsimit dhe të zbatohen nga profesionistë apo persona të trajnuar. Të gjitha palët e interesuara mund të këshillojnë për përmbajtjen dhe të japin mbështetje për programet edukative, por distribuimi i këtij komponenti duhet të bëhet me mbështetje të ekspertëve të edukimit, përfshirë edhe OSHC-të.*

b. *Është e rëndësishme të përfshihen të gjitha resurset e mundshme për edukim rreth mbajtjes dhe sjelljeve të qenve për t'u siguruar që mesazhet të jenë në përputhje me njëra-tjetrën. Idealisht këto resurse përfshijnë grupet e mirëqenies së kafshëve, veterinarët, shkollat, organet e zbatimit të ligjit, mediat.*

c. Veterinerët duhet të edukohen në fushën e menaxhimit të popullsisë së qenve, duke përfshirë:

- Rëndësinë e menaxhimit të popullsisë së qenve
- Rolin e tyre në çështjet e lidhura me shëndetin publik
- Metodën kirurgjike të kontrollit të riprodhimit
- Promovimin e mesazhit për mbajtje të përgjegjshme të qenve
- Angazhimin e tyre me punë etike dhe profesionale në programet aktive të menaxhimit të popullsisë së qenve

d. Mesazhet edukative mund të komunikohen në shumë mënyra, duke përfshirë:

- Ndërgjegjësimin e publikut të gjerë përmes kampanjave vetdijësuese, të cilat mund të bëhen përmes shtypit, billbordeve, radio, tv dhe rrjeteve sociale
- Seminaret zyrtare dhe ligjëratat e strukturuar në shkolla
- Broshurat dhe aktivitetet informative për komunitetin
- Angazhimin e komunitetit në diskutimet e programeve për menaxhim të popullsisë së qenve

Edukimi në shkolla dhe shoqëri është një masë e qëndrueshme që do të japë fryte në të ardhmen, duke e bërë shoqërinë kosovare më të vetëdijshme për mirëqenien e kafshëve dhe për ndikimin e kujdesit më të mirë ndaj kafshëve në shëndetin dhe mirëqenien e vet njerëzve.

Planifikimi i përgjegjshëm i mbajtjes së qenve është zgjidhja për parandalim të braktisjeve eventuale, kurse adoptimi i qenve të rrugës apo në strehimore do të kontribuonte në reduktimin e numrit të qenve endacak.

9.3 KONTROLLI I RREPTË I MBARËSHTIMIT DHE SHITJES SË QENVE SI KAFSHË SHOQËRUESE

Standardet e dobëta apo të pakontrolluara të mbarështimit dhe shitjes së qenve si kafshë shoqëruese, mund të shkaktojnë probleme të mëdha për mirëqenien, shëndetin dhe sjelljen e qenve të mbarështuar, duke bërë që shumë qen me probleme shëndetësore të braktisen në rrugë. Deri më tani, shteti nuk ka pasur ndonjë rregullore për këtë fushë dhe nuk ka punuar në inspektimin e mirëqenies së kafshëve në hapësirat aktuale të mbarështimit.

Kontrolli i mbarështuesve dhe i shitësve të qenve apo kafshëve të tjera shoqëruese, duhet të bëhet përmes ligjeve dhe akteve nënligjore, të cilat po ashtu duhet të gjejnë zbatim të mirëfilltë.

Mbarështimi dhe shitja mund të ndikohen gjithashtu përmes edukimit dhe fushatave vetdijësuese për pronarët e ardhshëm të qenve, për të siguruar që pronarët të dinë se çfarë të kërkojnë kur blejnë një qen dhe çfarë të bëjnë nëse shfaqen probleme me qenin e tyre të ri. Pronarët e ardhshëm duhet të informohen nga shteti për të gjitha përgjegjësitë që kanë ndaj kafshëve të tyre shoqëruese dhe të gjitha dënimeve potenciale që mund të vijnë nëse rrezikojnë mirëqenien e kafshëve apo shkelin ligjet e tjera në fuqi.

Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, specifikon në nenin 6, se mbarështimi i kafshëve duhet të bëhet sipas rregullave të përcaktuara për mbarështimin e kafshëve, përfshirë metodat e mbarështimit sipas llojit dhe kategorisë së tyre në mënyrë që të njëjtat të përdoren për parandalimin e mbarështimit të pakontrolluar. Pika 6.4. e ligjit në fjalë, specifikon se personi i përfshirë në mbarështimin e kafshëve është përgjegjës për ruajtjen e plotë të shëndetit apo mirëqenies të të vegjëlve dhe prindërve të kafshës që është mbarështuar. Megjithatë, ligji në fjalë nuk rregullon specifikat e tjera më të detajuara dhe e autorizon ministrinë përkatëse (MB-PZHR) që të nxjerrë akte nënligjore për të rregulluar çështjen e mbarështimit.

Do të thotë, duhet të prezantohet një udhëzim administrativ i ri, në mënyrë që të vihen kriteret dhe kushtet më strikte për mbarështuesit dhe shitësit e kafshëve shoqëruese, sidomos qenve.

Nga mosregjistrimi i qenve dhe qendrave mbarështuese dhe mungesa e kontrollit të duhur të qenve të mbarështuar dhe të shitur në Kosovë, nuk mund të planifikohet një program efikas dhe me rezultate pozitive sa i përket menaxhimit të popullsisë së qenve endacak.

Burimet e numrit të madh të qenve endacak në Kosovë duhet të trajtohen me prioritet dhe urgjencë dhe mbarështimi dhe shitja e pakontrolluar e qenve është njëra nga ato burime.

9.4 SUBVENCIONIMI I KASTRIMIT/STERILIZIMIT DHE VAKSINIMIT TË QENVE ME PRONAR

Ashtu siç është shpjeguar në pikën 5, një nga burimet kryesore të shtimit të numrit të qenve endacak është edhe shumimi i pakontrolluar i qenve në rrugë. Këtu hyjnë edhe qentë me pronar, të cilët janë të pa kastruar/sterilizuara, të cilët lihen të lirë të bredhin rrugëve, duke i rritur dukshëm gjasat për t'u shumuar me qen të rrugës.

Në Kosovë, shumica e pronarëve të qenve nuk i kastrojnë/sterilizojnë qentë e tyre.

Arsyet për këtë, janë një kombinim i një mendësie të dobët sa i përket kastrimit të qenve dhe mungesës së vetdijësisë dhe mjeteve financiare për të mbuluar shpenzimet e operimit për kastrim/sterilizim nga një numër i madh i pronarëve të qenve.

Një numër i madh i pronarëve të qenve kanë informata shumë të mangëta për benefitet shëndetësore²⁹ të kastrimit dhe sterilizimit të qenve të tyre, prandaj në të njëjtën kohë duhet të organizohen kampanja vetdijësuese për pronarët e qenve rreth benefiteve shëndetësore të kastrimit dhe sterilizimit.

Duke marrë parasysh vështirësitë e pronarëve që t'i sterilizojnë qentë e tyre por edhe nga hezitimi i shumë pronarëve që qentë e tyre të sterilizohen, për shkak të bindjeve të tyre personale, është e rëndësishme që kastrimi, sterilizimi dhe vaksinimi i qenve me pronar të ofrohen falas, të paktën për një periudhë të caktuar kohore, sidomos për ata që nuk kanë mundësi financiare t'i mbulojnë këto kosto.

Ofrimi falas i këtij shërbimi dhe informimi i saktë për benefitet e kastrimit, sterilizimit dhe vaksinimit do të motivonte shumë pronarë të kafshëve t'i kastrojnë/sterilizojnë qentë e tyre dhe kjo automatikisht do të ndikonte në parandalimin e rritjes së numrit të qenve endacak në vend.

9.5 KONTROLLI I RIPRODHIMIT – PËRMES METODËS KSVL

Kontrolli i riprodhimit është konsideruar prej kohësh si një mjet për të ulur numrin e popullsisë së qenve. Ekzistojnë metoda të ndryshme për kontrollin e riprodhimit, por sterilizimi kirurgjikal i qenve femra dhe kastrimi i qenve meshkuj është aktualisht opsioni më i besueshëm. Sterilizimet kirurgjikale duhet të kryhen gjithmonë nga një veteriner i kualifikuar.

Kur aplikohen projektet për kastrim dhe sterilizim, është e rëndësishme të merret parasysh qëndrueshmëria e tyre – menaxhimi i popullsisë së qenve endacak është një sfidë e përhershme, kështu që është thelbësore që të konsiderohet kontinuiteti i projekteve të KSVL-së gjatë hartimit të projekteve shtetërore.

Heqja e organeve riprodhuese nën anestezi të përgjithshëm siguron sterilizim të përhershëm dhe mund të ulë dukshëm sjelljen seksuale (veçanërisht nëse kryhet në fazat e hershme të zhvillimit të një kafshe, por jo më herët se 7 muaj nga lindja e tyre). Pas ndërhyrjes kirurgjike, një standard i lartë i asepsisë³⁰ dhe menaxhimit të dhimbjeve duhet të mbahet gjatë gjithë kohës. Kjo mund të arrihet vetëm përmes monitorimit adekuat pas operacionit gjatë gjithë periudhës së rikuperimit.

29 <https://www.aspc.org/pet-care/general-pet-care/spayneuter-your-pet>

30 Asepsia - praktika e zvogëlimit ose eliminimit të rrezikut të kontaminimit bakterial. Nga shumë praktika të vendeve të zhvilluara të BE-së#, përgjegjësia ligjore dhe ekzekutive për menaxhimin e duhur të popullsisë së qenve endacak i takon qeverisë lokale dhe qendrore, ashtu siç parashihet edhe me legjislacionin në fuqi edhe në Kosovë. Entitetet joqeveritare dhe jo-fitimprurëse për mirëqenien e kafshëve nuk duhet të inkurajohen ose të përpiqen të marrin përgjegjësinë kryesore të menaxhimit të popullsisë së qenve endacak, përveçse përmes një marrëveshje kontraktuale qoftë me punë vullnetare ose me fonde dhe burime të përshtatshme për të kryer punë efektive dhe të qëndrueshme brenda mandatit të një institucioni shtetëror gjegjës për mirëqenien e kafshëve dhe menaxhimin e projekteve që prekin trajtimin ligjor dhe human të qenve endacak.

Kirurgjia mund të duket fillimisht e kushtueshme, por është një zgjidhje e përhershme dhe kështu ka kosto më efektive në një periudhë afatgjate. Ky lloj intervenimi, përveç veterinerëve të trajnuar, po ashtu kërkon një infrastrukturë të mirëfilltë dhe pajisje profesionale ashtu siç kërkohet në Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) 04/2017 për kushtet teknike të cilat duhet plotësuar qendrat e trajtimit të përkohshëm të kafshëve endacake.

Meqenëse në Kosovë është e domosdoshme të bëhet kontrolli i riprodhimit për qentë endacak, është e rëndësishme që kjo të bëhet përmes metodës KSVL.³¹

Projektet e KSVL-së për qentë endacak duhet të implementohen në vazhdimësi dhe nuk duhet asesi të ndërpriten me muaj të tërë, ashtu siç ka ndodhur deri më tani në Kosovë. Nëse projektet e KSVL-së nuk janë aktive gjatë tërë kohës, do të jetë shumë e vështirë që të menaxhohet siç duhet popullsia e qenve endacak në Kosovë, prandaj të gjitha komunat e Kosovës duhet të planifikojnë buxhet vjetor për të implementuar këto projekte. Projektet e KSVL-së si të vetme nuk mund të jenë të suksesshme në zvogëlimin e numrit të qenve endacak, por gjithsesi është një komponent tejet i rëndësishëm në menaxhimin efektiv dhe human të popullsisë së qenve endacak, prandaj duhet të zbatohen së bashku me masa të tjera të nevojshme për zvogëlimin e numrit të qenve endacak.

9.6 QENDRAT PËR TRAJTIM TË PËRKOHSHËM DHE QENDRAT E SHPËTIMIT

Ndërtimi i strehimoreve tradicionale për strehim të përhershëm të qenve endacak, nuk është një masë themelore e një programi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të popullsisë së qenve endacak. Mirëqenia e qenve në ambiente të tilla mund të jetë shumë e dobët dhe mbajtja e qenve në strehimore kushton jashtëzakonisht shumë edhe për shtetet e pasura dhe të zhvilluara, e të mos flitet për shtetet me zhvillim ekonomik dhe social të ngadalshëm siç është Kosova.

Në situatën e tanishme me qentë endacak, ndërtimi i strehimoreve si masë urgjente për zvogëlimin e numrit të qenve endacak, do të kishte kosto tejet të lartë, dhe nuk do të kishte aspak efekt për zvogëlimin e numrit të qenve në rrugë, pasi që strehimoret mbushen shpejt deri në kapacitetet e tyre të plota, ndërsa qentë zëvendësohen në rrugë përmes shumimeve të vazhdueshme dhe braktisjes. Prandaj, strehimoret, pa mbështetje financiare, pa sistematizim të punës, pa zbatim të masave të tjera për menaxhim të popullsisë së qenve endacak, dhe pa gatishmërinë e qytetarëve për të adoptuar qen, do të mbipopullohen shpejt dhe do të nxisin pronarët t'i braktisin qentë e tyre afër strehimoreve dhe në rrugë.

Në Kosovë, dy herë është tentuar të menaxhohet numri i qenve endacak përmes funksionalizimit të strehimoreve komunale publike, në komunën e Graçanicës³² dhe të Pejës³³, dhe në të dyja rastet, funksionalizimi i këtyre strehimoreve ka dështuar, për shkak të neglizhencës institucionale, mungesës së planifikimit efektiv të menaxhimit, mungesës së transparencës dhe llogaridhënies nga komuna, si dhe tejkalimit të kapaciteteve të strehimoreve përmes grumbullimit të vazhdueshëm të qenve endacak, pa qasje të qëndrueshme për të ndalur paralelisht edhe me burimin e shtimit të numrit të qenve endacak në rrugë.

31 Kjo metodë është shpjeguar në shumë detaje në pikën 3

32 <https://www.youtube.com/watch?v=CVkcgxLGtNO>

33 <https://telegafi.com/strehimore-apo-thertore-masaker-e-qenve-ne-peje-fotovideo18/>

E tërë kjo situatë ka bërë që të rrezikohet dukshëm mirëqenia e kafshëve në këto strehimore, e që në shumë raste ka pasur përfundim tragjik për qentë, e në anën tjetër, situata me qentë në rrugë nuk ishte përmirësuar aspak. **Prandaj, strehimoret nuk duhet të konsiderohen si prioritet kryesor në vendet si Kosova, ku ka numër të madh të qenve në rrugë dhe adoptime minimale.**

Nëse konsiderohet ndërtimi i strehimoreve, menaxhimi i tyre dhe kushtet e mbajtjes e qenve në ato hapësira duhet të rregullohen me akte ligjore, dhe secila prej strehimoreve duhet të licencohet nga AUV. Përndryshe, strehimoret, pa punë transparente dhe pa llogaridhënie, shpesh mund të bëhen qendra fitimprurëse për pronarët e tyre, që përdorin donacione për veten e tyre dhe fitojnë para nga mbajtja e keqe e qenve aty.

Megjitatë, themelimi i qendrave shpëtuese (ang. sanctuaries), hapësirave/strukturave me sisteme të ristrehimit për qentë, që sigurojnë strehim të përkohshëm për qentë deri në adoptimin e tyre, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e suksesshëm të kësaj strategjie dhe programit të saj. Krijimi i qendrave të përkohshme të strehimit apo ndryshe të njohura edhe si 'qendra të shpëtimit' mund të jetë ndihmesë e madhe që qentë e trajtuar të rrugës, të adoptohen nëpër familje.



Deri më tani, në Kosovë këto qendra shpëtimit, kanë luajtur një rol të rëndësishëm për shpëtimin e shumë qenve të rrugës që kishin probleme të mëdha shëndetësore, qenve të aksidentuar, këlyshëve të rrezikuar nga faktorë të ndryshëm dhe qenve me probleme me sjellje të cilët nuk kanë mundur të ambientohen me jetën në rrugë. Po ashtu, këto qendra nëpërmjet organizimit jo formal të individëve apo edhe nëpërmjet organizatave jo-qeveritare (vendore dhe të huaja) lehtësojnë dhe organizojnë adoptime të shumta të qenve endacak të Kosovës edhe pse deri më tani nuk kanë publikuar ndonjë raport apo të dhënë se sa qen janë adoptuar, përveç organizatës zvicerane, "StrayCoco Foundation". Kjo organizatë, ka themeluar dy qendra të trajtimit të përkohshëm, ashtu siç parashihet me UA (MBPZHR) 04/2017. Këto qendra janë të vetmet që funksionojnë sipas secilit kusht dhe standard që është kërkuar nga ky UA, duke iu ndihmuar jashtëzakonisht shumë qenve endacak në Kosovë.

Gjatë tenderimit të projektit të AUV-së për trajtimin e qenve endacak, kjo e fundit ka kërkuar nga veterinerët që qendrat e tyre të trajtimit të qenve endacak, të plotësojnë kushtet e kërkuara në UA (MBPZHR) 04/2017. Jo të gjitha qendrat kishin plotësuar kushtet për të punuar në trajtimin e qenve endacak.

Në vitin 2020, në tërë Kosovën ishin aktive 29 qendra³⁴ të trajtimit të përkohshëm për të kryer shërbimin e trajtimit të qenve endacak me anë të metodës KSVL. Sipas AUV-së këto qendra ende nuk janë licencuar, ngaqë shumë nga to ende kanë shumë kushte për të përmirësuar para se të licencohen. AUV nuk duhet t'i licencojë qendrat të cilat nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi.

Vlerësimi i gjendjes së qendrave të improvizuara të subjekteve veterinarë është bërë nga FDK, nga më shumë se 150 vizita monitoruese gjatë projektit shtetëror në vitin 2020.

Nga 29 qendra të improvizuara të subjekteve veterinarë, vetëm shtatë (7) qendra kishin kushte shumë të mira të hapësirës për strehimin e qenve për 5-7 ditë pas operacionit. Këto qendra po ashtu kishin kushte të mira të punës, stafin e përgatitur (të trajnuar, por jo me trajnime profesionale) për të bërë zënien e qenve në rrugë dhe veterinerë të kualifikuar për trajtimin e kafshëve të vogla, siç është qeni. Vetëm një qendër është vlerësuar nga FDK që plotëson dhe tejkalon kushtet e kërkuara nga UA (MBPZHR) 04/2017.



.....
34 https://AUV.rks-gov.net/repository/docs/Lista_e_subjekteve_te_kontraktuara_per_projektin_Menxhimi_dhe_kontrolli_i_qenve_endacak_08052020_1.pdf



Tetë (8) nga njëzetënëntë (29) qendra, ishin të vlerësuara në gjendje shumë të keqe, dhe tri (3) nga to janë raportuar me kallëzime penale në Prokurori, të paraqitura nga FDK. Po ashtu, nëntë (9) qendra, janë vlerësuar si të mira, kurse të tjerat (5) kishin një gjendje deri diku të pranueshme, por me kusht që këto qendra të përmirësohen në vijim, për të garantuar punë serioze dhe respektim të plotë të mirëqenies së qenve endacak që trajtohen në to.

Siç është thënë më lartë, edhe pse ka organizata të huaja apo edhe vendore që merren me strehimin e qenve të rrugës dhe që mundësojnë adoptimin e qenve që strehojnë,³⁵ nuk është e mjaftueshme dhe nuk mund të mbulohet i gjithë numri i qenve të rrugës për t'u strehuar vetëm nga pak individë apo organizata, pa ndihmën e shtetit përmes fondeve më të qëndrueshme dhe veprimeve të cilat gradualisht e zvogëlojnë numrin e qenve në rrugë.

Qeveria e Kosovës duhet të investojë në themelimin dhe përmirësimin e Qendrave për Trajtim të Përkohshëm siç kërkohet me legjislacionin në fuqi, dhe në të njëjtën kohë të hapë qendra të shpëtimit, në rast se një qen duhet të dorëzohet nga pronari/ja për shkaqe të ndryshme, vetëm e vetëm që kafshët të mos braktisen në rrugë.

Për ta bashkuar konceptin e qendrave të shpëtimit me adoptimet (vetëm në këtë rast strehimi ka kuptim dhe është i qëndrueshëm), Qeveria e Kosovës mund të bashkëpunojë dhe po ashtu të financojë/subvencionojë, individë, biznese apo organizata në Kosovë, që veçse merren me shpëtimin e qenve të rrugës dhe adoptimin e tyre.

.....
 35 Është vërtetuar shumë herë nga përvoja e punës së aktivistëve të mbrojtjes së kafshëve, që aytetarët e Kosovës, shumë pak adoptojnë ndonjë qen nga strehimoret apo direkt nga rruga. Shumica e rasteve të adoptimeve të qenve të rrugës, bëhen nga njerëz dhe familje jo kosovare/shqiptare.

Duhet të konsiderohet edhe mundësia e vendosjes së taksës komunale për mbajtjen e qenve apo kafshëve shoqëruese, në mënyrë që pushteti lokal të ketë në dispozicion një fond i cili do të shërbente për të përmirësuar jetën e qenve të rrugës dhe do të kontribuonte në rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë sa i përket mbajtjes së përgjegjshme të kafshëve.

Gjithsesi duhet të theksohet se qendrat e shpëtimit nuk do të jenë strehimore në kuptimin klasik, ku strehohen kafshët dhe mbesin aty gjatë tërë jetës së tyre nëse nuk adoptohen. Mbajtja e qenve në kafaze dhe strehimore të çfarëdoshme për një periudhë të gjatë, mund të shkaktojë depresion, stres dhe agresivitet tek qentë. Veçoritë negative pastaj bëjnë që qentë të mos jenë të adoptueshëm dhe rrezikojnë të mbesin në hapësira të izoluara gjatë gjithë jetës së tyre, pa ndonjë familje apo individ që do të kujdesej për ta. Prandaj, qendrat e shpëtimit funksionojnë vetëm nëse aplikohet edhe qasja e qenve të komunitetit (qen që jetojnë të lirë por nën përkujdesje) nën përkujdesjen e **'Kujdestarëve të Lagjës'** për qentë endacak.

9.7 PREZANTIMI I 'KUJDESTARËVE TË LAGJES PËR KAFSHËT ENDACAKE'

Një nga metodat apo masat e qëndrueshme të menaxhimit të qenve endacak, është edhe monitorimi i vazhdueshëm i tyre në rrugë, përderisa shteti nuk ka ende struktura të mirëfillta të strehimit të tyre.

Monitorimi i gjendjes së qenve endacak ka të bëjë me numërimin e tyre, me gjendjen e tyre shëndetësore, me sjelljen e tyre dhe dinamikën e lindjeve dhe vdekjeve të këlyshëve dhe qenve, në lagjet specifike të të gjitha qyteteve dhe fshatrave të Republikës së Kosovës. Po ashtu, është shumë e rëndësishme që të identifikohen qentë pa vath në rrugë; që do të thotë, qentë të cilët janë ende të patrajtuar. Kujdestarët e lagjeve do të vërejnë edhe braktisjet e reja dhe do të mbajnë evidenca në mënyrë që çdo gjë të strukturohet me të dhëna dhe fakte, ashtu që institucionet përgjegjëse të kuptojnë më mirë se cilat masa duhet të zbatohen më shpejtë dhe cilat mund të presin edhe më tej. Prioritizimi i masave për menaxhimin e numrit të qenve endacak është i rëndësishëm për implikimet financiare që institucionet e nivelit qendror dhe lokal duhet të bëjnë për këtë çështje.

Kujdestarët e lagjeve po ashtu do të kenë përgjegjësinë që t'iu lajmërohen thirrjeve të qytetarëve në rast se dyshohet se një qen ka probleme shëndetësore ose tregon agresivitet apo shkakton probleme të tjera për qytetarët. Po ashtu, kujdestarët e lagjes kanë për detyrë t'i informojnë qytetarët mbi natyrën e qenit dhe sjelljet e tyre.

Siç është thënë më lartë, shteti i Kosovës nuk ka bërë asgjë deri më tani në lidhje me ndërgjegjësimin e qytetarëve, kështu që angazhimi i 'kujdestarëve të lagjes' për të bërë gjithashtu edhe vetdijësimin e qytetarëve, është mjaft efektiv dhe do të ndihmonte jashtëzakonisht shumë në menaxhimin e qëndrueshëm të popullsisë së qenve endacak në Kosovë.

Me anë të kësaj mase, komunat do të tregohen më përgjegjëse ndaj qytetarëve që ankohen dhe frikësohen nga qentë endacak.

Vaksinimi i qenve endacak kundër tërbimit do të jetë shumë më i evidentueshëm dhe serioz, po ashtu edhe karshi komunitetit ndërkombëtar, i cili i kushton vëmendje të veçantë çrën-sosjes së sëmundjes së tërbimit në Kosovë.

Një shembull për masën e 'kujdestarëve të lagjes' mund të merret nga Italia, ku komunat me mbështetje të shoqatave për mirëqenien e kafshëve prezantojnë konceptin e "qenit të lirë dhe nën përkujdesje". Ky është një koncept i parashikuar në pjesë të ndryshme të Italisë së Jugut, me qentë e rrugës si një subjekt i pranishëm brenda komunitetit. Kafshët endacake duhet të identifikohen me mikroçip dhe të regjistrohen në regjistrin e kafshëve shoqëruese në emër të komunës së cilës i përkasin dhe duhet të vaksinohen dhe kastohen/sterilizohen dhe Komuna merr përgjegjësi të plotë në rast të ndonjë dëmtimi ndaj palëve të treta, nga qentë me status të tillë. Qentë e lirë, mund të vihen nën përkujdesjen e qytetarëve, të cilët duhet të lajmërohen pranë komunës, për t'u regjistruar si kujdestar i ndonjë qeni endacak në Jug të Italisë.³⁶

Në Jug të Italisë kjo është një zgjidhje e parashikuar nga disa ligje rajonale që zbatojnë Ligjin Kornizë n.281 / 91 dhe nga Qarkorja n. 5 e datës 14 maj 2001 e Ministrisë së Shëndetësisë, e cila mund të përcaktohet nga kryetari i komunës, i cili është kryesisht përgjegjës për mirëqenien e të gjitha kafshëve të pranishme në zonën e komunës.³⁷

9.8 KONTROLLI I QASJES NË RESURSE

Qentë zakonisht kanë qasje në resurse (përfshirë ushqimin, ujë dhe strehimin), të cilat mund të jenë në dispozicion direkt nga një pronar brenda kufijve të një shtëpie, kurse në rastin e qenve endacak, këto burime sigurohen në prona publike, qoftë nga mbeturinat, qoftë nga vet qytetarët të cilët kujdesen për kafshët e komunitetit.

Disa qen me pronar lihen të lirë të bredhin rrugëve, gjë e cila konsiderohet si mbajtje e pa-përgjegjshme, për shkak të mundësisë për qasje në resurse në hapësira publike, por nuk mbështeten në këto resurse për mbijetesë, ndërsa qentë endacak janë plotësisht të varur për mbijetesë nga resurset e gjetura gjatë bredhjes së tyre në rrugë.

Mungesa e resurseve të mjaftueshme për mbijetesë në rrugë, në zonat e banuara mund të shfaqë shqetësime për siguri publike, pasi që qentë endacak mundohen t'i mbrojnë me çdo kusht ato pak burime të ushqimit dhe ujit në të cilat hasin gjatë jetës në rrugë.

Kontrolli i qasjes në resurse në hapësira publike do të ndikojë në popullsinë e qenve endacak, pasi që dekurajon bredhjen në kërkim të resurseve të ushqimit.

Megjithatë, ky kontroll mund të zvogëlojë gjasat për mbijetesë për qentë të cilët varen nga këto resurse.

.....
³⁶ <https://www.lav.it/news/prevenire-abbandonato>
³⁷ <https://www.normattiva.it/atto/caricaDettaglioAtto>

Disa çështje duhet të merren parasysh gjatë zbatimit të këtij komponenti:

1. Ndërhyrja e zvogëlimit të qasjes në resurse nuk duhet të përdoret si masë e vetme. Për ato kafshë të identifikuar si të varura nga resurset në hapësira publike për mbijetesë, ndryshimet në qasje në këto resurse duhet të bëhen në hap me uljen e numrit të popullsisë së qenve endacak ose duke marrë masa alternative për ato kafshë të cilët varen nga këto resurse. Kjo mund të bëhet përmes vendosjes së pikave ushqyese për qentë endacak, larg zonave të banimit, për të evituar konfliktet e mundshme njeri-kafshë, në mbrojtje të resurseve.
2. Përmirësimi i mbledhjes dhe hedhjes së mbeturinave mund të ndikojë në zvogëlimin e ndërveprimit midis njerëzve, veçanërisht fëmijëve, dhe qenve endacak të uritur dhe të cilët mund të bëhen agresiv në mbrojtje të resurseve ushqimore.
3. Në disa situata, burimi kryesor i ushqimit do të jetë ushqimi i siguar direkt nga njerëzit përmes ushqimit të qëllimshëm. Motivimi për ushqim do të ndryshojë midis zonave gjeografike dhe midis individëve dhe kjo duhet të kuptohet dhe merret në konsideratë nëse përpqet të ndikohet në sjelljen e njerëzve të cilët ushqejnë qentë endacak, (p.sh. shih pikën 4, më poshtë). Edukimi dhe vetdijësimi luajnë një rol të rëndësishëm në ndikimin e kësaj sjellje.
4. Kontrolli i qasjes në resurse në hapësira të veçanta mund të përdoret për të ndryshuar përhapjen e popullsisë së qenve. Për shembull, një park publik në të cilin njerëzit nuk duan të ketë prezencë të qenve endacak, mund të mirëmbahet duke ndaluar qasjen në burime të ushqimit dhe ujit, përmes masave si vendosja e koshave të mbeturinave të cilat janë të paarrtshme nga kafshët, dhe edukimi i njerëzve që të mos ushqejnë qentë në këto hapësira. Në disa vende ekzistojnë rregullore që kufizojnë hapësirat ku qentë mund të ecin ose vrapojnë lirshëm.

10. PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Përmes kësaj analize ligjore përbrenda 'Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Popullsisë së Qenve Endacak në Kosovë' synohet që të paraqiten në mënyrë të qartë kompetencat e institucioneve relevante të Republikës së Kosovës, në raport me kontrollin dhe menaxhimin e qenve endacak. Në bazë të analizës ligjore të bërë nga FDK, është gjetur se institucionet më kompetente në raport me kontrollin dhe menaxhimin e qenve endacak janë:

1. *Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;*
2. *Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe*
3. *Autoritetet Komunale (Komunat)*

Janë analizuar të gjitha bazat e mundshme ligjore nga të cilat rrjedhin kompetencat e institucioneve përkatëse, dhe në këtë drejtim janë listuar një nga një secili institucion publik relevant, duke filluar nga institucionet më të larta në hierarkinë shtetërore e deri tek ato më të ultat, përkatësisht duke filluar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, deri tek Autoritetet Komunale (Komunat).

10.1 BAZA LIGJORE E KONSULTUAR

Ligji nr. 02/L-10 për Përkujdesjen ndaj Kafshëve (tutje referuar si "Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve")

Ligji nr. 2004/21 për Veterinarinë (tutje referuar si "Ligji për Veterinarinë")

Ligji nr. 03/L-016 për Ushqimin (tutje referuar si "Ligji për Ushqimin")

Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (tutje referuar si "Ligji për Vetëqeverisje Lokale")

Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura;

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - nr. 04/2017 për Kushtet Teknike të cilat duhet Plotësuar Qendrat e Trajtimit të Përkohshëm të Kafshëve Endacake (tutje referuar si "Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të cilat duhet Plotësuar Qendrat e Trajtimit të Përkohshëm të Kafshëve Endacake")

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - nr. 02/2018 për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese (tutje referuar si "Udhëzimi Administrativ për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese")

Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - nr. 02/2021 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) nr. 02/2018 për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese

Udhëzim Administrativ nr. 07/2006 për Themelimin e Komisionit të Përhershëm për Mbarëshkrimin e Kafshëve (tutje referuar si "Udhëzimi Administrativ për Themelimin e Komisionit të Përhershëm për Mbarëshkrimin e Kafshëve")

Rregullore nr. 03/2010 për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (tutje referuar si "Rregullore për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë").

Rregullore QRK - nr. 29/2013 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 03/2010 për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, e miratuar në mbledhjen e 151 të Qeverisë së Republikës së Kosovës (tutje referuar si "Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë")

Rregullore (K.VU) 01. nr. 87/15 për Kushtet e Mbajtjes së qenve dhe maceve si dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre (tutje referuar si "Rregullore për Kushtet e Mbajtjes së qenve dhe maceve si dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre")

Rregullore (K.DE) 01. nr. III.2 për Kushtet e Mbajtjes së qenve si dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre dhe strehimorja e qenve endacak (tutje referuar si "Rregullore për Kushtet e Mbajtjes së qenve si dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre dhe strehimorja e qenve endacak")

10.2 AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL NË RAPORT ME KONTROLLIMIN DHE MENAXHIMIN E QENVE ENDACAK

Një prej institucioneve publike i cili është i detyruar që të kujdeset për zbatimin e Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.³⁸

Me nenet 4, 5 dhe 6 të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, janë të caktuara disa nga autorizimet dhe përgjegjësitë që i ka Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të cilat autorizime dhe përgjegjësi lidhen direkt me mbrojtjen e kafshëve, mirëqenien e tyre, si dhe me kontrollimin e shtimit të numrit të tyre.

Në nenin 4, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve është caktuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është përgjegjëse që me akt nënligjor të rregullojë: 1. Mënyrën me të cilën lidhen kafshët; 2. Mënyrën me të cilën do të ndahen kafshët sipas moshës, gjinisë apo llojit; 3. Hapësirën e lejuar për kafshë; 4. Çështjet që lidhen me higjienë dhe komoditet të kafshës, strehimin e tyre dhe masave tjera për të siguruar shëndetin e kafshës; 5. Të dhënat për hartimin e listës së kategorive dhe llojeve të kafshëve; 6. Kushtet e strehimit të kafshëve sipas llojit të tyre; dhe 7. Çfarëdo çështje tjetër që mund të paraqitet. Sipas këtij neni, është në kompetencën e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që t'i përcaktojë kushtet nën të cilat duhet të mbahet një kafshë. Pra, neni 4, i Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, shprehimisht e përcakton se mbajtësit e kafshëve (pa marrë parasysh se kush është mbajtës i kafshës), janë të obliguar që ta mbajnë një kafshën sipas kushteve të cilat i përcakton Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Po ashtu, konform nenit 5, paragrafi 2, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është kompetente që përmes akteve nënligjore të përcaktojë mënyrën e kujdesit, të ushqyerit, stërvitjes, dhënies së ujit, si dhe përcaktimin e personave të kualifikuar që do të jenë përgjegjës për përkujdesjen e kategorive dhe llojeve të tyre. Sipas këtyre dispozitave, çdo person i cili kujdeset për kafshë, pa marrë parasysh cilësitë e tij, duhet që të kujdeset për mirëqenien e kafshës që e mbanë dhe i njëjti duhet që ta zbatojë këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me të cilat konkretizohen dispozitat e Ligjit për Përkujdesje ndaj Kafshëve. Duhet të potencohet se dispozitat ligjore dhe nënligjore, të cilat dalin nga Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, duhet zbatuar nga ana e çdo personi i cili është mbajtës i kafshës³⁹. Pra, këto dispozita duhet zbatuar si nga ana e personave fizik, ashtu edhe nga ana e personave juridik pa marrë parasysh se kush është. Në vendin tonë, deri më tani, nuk ekziston ndonjë akt nënligjor i nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me kushtet e mbajtjes së kafshëve shoqëruese, siç është qeni, apo macja, si dhe përkujdesjen ndaj tyre.⁴⁰

38 Duhet të potencohet se sipas nenit 3, pika 2, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, fjala "Ministria" që është përdorur në tekstin e këtij ligji ka kuptimin "Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

39 Sipas definicionit të dhënë në nenin 3, pika 6, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, "Mbajtës i kafshës" nënkupton personin i cili ka në ruajtje ose kujdeset për kafshën.

40 Një akt të tillë nënligjor me të cilin konkretisht përcaktohen kushtet e mbajtjes së qenve dhe maceve, në vitin 2015 ka nxjerrë Komuna e Vushtrrisë. Lidhur me përmbajtjen e këtij akti nënligjor, sqarimet do të afrohen në pjesën e kësaj analize ligjore që ka të bëjë me kompetencat dhe përgjegjësitë e komunave në raport me trajtimin e qenve endacak si dhe me menaxhimin e numrit të tyre.

Është më rëndësi të potencohet se konform nenit 6, paragrafi 5, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është kompetente për ta rregulluar çështjen e mbarështimit të kafshëve në të gjitha aspektet e saj, ashtu siç u shpjegua edhe më lartë. Sipas këtij neni, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duhet të nxjerrë akt nënligjor, ku do të specifikohet se cilat janë rregullat që duhet ndjekur për mbarështimin e kafshëve nga ana e mbajtësve të kafshëve. Lidhur me mbarështimin e kafshëve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ për Themelimin e Komisionit të Përherëshëm për Mbarështimin e Kafshëve. Sipas këtij udhëzimi, ky komision ka kompetencë që t'i jap propozime Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, propozime këto që kanë të bëjnë më mbarështimin e kafshëve në të gjitha aspektet, mirëpo ministria në fjalë nuk ka nxjerrë akt nënligjor me të cilin rregullohet çështja e mbarështimit të kafshëve.

Ashtu siç është cekur më lartë, konform Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka për obligim që të nxjerrë akte nënligjore dhe përmes tyre të zbatojë Ligjin për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, duke përcaktuar mënyrën e mbajtjes së kafshëve dhe kujdesjen ndaj tyre, mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve si dhe **aj** **çka është më e rëndësishmja në raport me kontrollimin e shtimit të numrit të qenve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse që me akte nënligjore të vendosë rregulla për mbarështimin e kafshëve.**

Për t'u kujdesur për zbatimin e Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve dhe zbatimin e udhëzimeve të cilat i nxjerrë, konform nenit 15, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka në dispozicion Inspektoratin për Përkujdesje dhe e njëjta është e detyruar që përmes Inspektorit

për Përkujdesje ndaj Kafshëve, të kujdeset që mbajtësit e kafshëve janë duke e zbatuar Ligjin për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, si dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në nenin 15, paragrafi 1, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, shprehimisht është e caktuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes Inspektoratit për përkujdesje ndaj kafshëve, kujdeset për zbatimin e Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve.

Konform nenit 16, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, Inspektori për përkujdesje ndaj kafshëve, ka të drejtë që të ketë qasje në çdo vend që përdoret tërësisht apo pjesërisht si vendbanim i kafshëve, për të konstatuar shkelje të mundshme të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, nga ana e mbajtësve të kafshëve. Pra, Inspektorati, është i autorizuar që të kujdeset nëse mbajtësit e kafshëve janë duke i zbatuar rregullat e mbarështimit të kafshëve.

Inspektorati për Përkujdesje ndaj Kafshëve, ka të drejtë që konform nenit 17, pika (b) të Ligjit për Përkujdesjen ndaj kafshëve, t'i shqiptojë gjobë nga 100 deri në 5.000 euro, secilit person i cili vepron në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore, me të cilat rregullohet çështja e mbarështimit të kafshëve.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Veterinarinë ka për detyrë që të nxjerrë akte nënligjore për të përcaktuar procedurat sipas të cilave Autoritetet Komonale (Komunat) duhet të bëjnë: a) Regjistrimin e qenve; b) Vaksinimin vjetor kundër tërbimit dhe dehelmentizimin kundër ekinokokëve; c) Kapjen e qenve dhe maceve të rrugës dhe nëse është e nevojshme, eutanazinë e tyre; d) Largimin dhe hedhjen e sigurt të trupave të përmendura në pikën (c); e) Themelimin e vendeve për përkujdesje për qentë dhe macet, sipas nevojës.

10.3 AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E AGJENCISË SË USHQIMIT DHE VETERINARISË (AUV) NË RAPORT ME KONTROLLIMIN DHE MENAXHIMIN E QENVE ENDACAK

AUV është Agjenci ekzekutive e Qeverisë përkatësisht Zyrës së Kryeministrit, dhe e cila është e thirrur që të mbrojë jetën dhe shëndetin e njerëzve duke siguruar nivel të lartë të ushqimit të sigurt, përfshirë edhe ushqimin e kafshëve, shëndetin e kafshëve, përkujdesjen ndaj kafshëve si edhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit me prejardhje bimore dhe shtazore. AUV është themeluar me Ligjin për Ushqimin dhe është e organizuar në bazë të Rregullores për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 03/2010 për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.⁴¹

Konform legjislacionit të Republikës së Kosovës disa prej detyrave që i ka AUV si institucion publik, kanë të bëjnë me trajtimin e qenve endacak dhe parandalimin e shtimit të numrit të tyre si dhe ofrimin e kujdesit për mirëqenien e tyre.

Duhet potencuar se lidhur me kontrollimin dhe parandalimin e rritjes së numrit të qenve endacak, kompetencat e AUV derivojnë nga disa baza ligjore, sipas të cilave, AUV në mënyrë direkte apo të tërthortë ka rol në kontrollimin dhe parandalimin e rritjes së numrit të qenve endacak.

Konform nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, AUV është kompetente për licencimin e vendstrehimeve për kafshët pa pronar dhe kafshët me pronar.

Në nenin 14, paragrafi 1, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve theksohet se "Rezervatet, vendstrehimet e kafshëve pa pronar dhe vendstrehimet e kafshëve me pronar mund të mbahen vetëm pas marrjes së licencës nga SHVUK." Pra, sipas këtij neni, AUV është përgjegjëse për licencimin e subjekteve të cilat i strehojnë kafshët endacake.

Ndërsa në nenin 14, paragrafi 2, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, shprehimisht caktohet se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është kompetente për të përcaktuar mënyrë e licencimit dhe rregullimin e vendstrehimeve. Pra, sipas nenit 14, paragrafi 2, të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka përgjegjësi që të caktoj procedurën dhe kriteret e licencimit të vendstrehimeve të kafshëve pa pronar dhe me pronar. Në nenin 17, paragrafi 1, pika (o), të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, shprehimisht është e caktuar se subjektet të cilat themelojnë vendstrehime për kafshë dhe nuk marrin licencën pranë AUV-së ashtu siç është e përcaktuar me nenin 14, paragrafi 1, të këtij ligji, do të gjobiten për kundërvajtje me gjobë prej 100 deri 5.000 Euro.

AUV është përgjegjëse po ashtu edhe për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve. Kjo kompetencë e AUV-së buron nga Rregullorja për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe nga Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Sipas nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Rregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin

.....
41 Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është themeluar në bazë të nenit 36 të Ligjit për Ushqimin. Para themelimit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, përgjegjësisë të cilat i ka tani ky institucion kanë qenë të shpërndara në disa institucione. Një prej tyre ka qenë Shërbimin Veterinar dhe të Ushqimit të Kosovës apo SHVUK, ku në bazë të Ligjit për Veterinarinë, ky institucion ka qenë agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 03/L-016 për Ushqimin, SHVUK është zëvendësuar me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Rrjedhimisht, në të gjitha ligjet ku thuhet SHVUK, kemi të bëjmë me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, apo AUV.

e Rregullores për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Drejtoria për Shëndetin dhe Mirëqenien e Kafshëve, në kuadër të AUV, është përgjegjëse për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, si dhe monitorimin e lëvizjes së tyre. Pra, në bazë të kësaj rregulloreje AUV ka përgjegjësi që të kujdeset për identifikimin, regjistrimin dhe monitorimin e lëvizjes së të gjitha kafshëve në Republikën e Kosovës.

Detyrimi i AUV për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve buron edhe nga neni 12, paragrafi 2, i Ligjit për Veterinarinë, ku sipas këtij neni AUV duhet të mbajë një regjistër qendror për regjistrimin dhe identifikimin e kafshëve. Neni 12, paragrafi 1, i Ligjit për Veterinarinë, e specifikon se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka kompetencë që të nxjerrë udhëzime administrative që në përputhje me këtë ligj të vendosë sisteme për identifikim dhe regjistrim të kafshëve.

Duhet theksuar se konform neni 12, paragrafi 1, të Ligjit për Veterinarinë dhe neni 4, paragrafi 1, pika (g) të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese. Në neni 1, të këtij udhëzimi thuhet se "Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kriteret, procedurat për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve shoqëruese, dhe mbajtjen e regjistrit qendror të tyre me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve". Pra, qëllimi i këtij udhëzimi është që të themelohet një regjistër qendror, i cili regjistër konform përkufizimit të dhënë në neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Udhëzimit Administrativ për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese, i referohet regjistrit për regjistrimin e kafshëve shoqëruese që duhet ta mbajë AUV. Duhet të theksohet se sipas përkufizimit të dhënë në neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Udhëzimit Administrativ për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese, emërtimi "Kafshë shoqëruese" sipas këtij udhëzimi nënkupton qentë dhe macet me pronar.

Pra, konform neni 1, në lidhje me neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, ky udhëzim dhe Udhëzimi Administrativ 02/2021 – Për ndryshimin dhe plotësimin e UA (MBPZHR) 02/2021 – Për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese, aplikohen për qentë dhe macet me pronar, dhe se regjistrimi në regjistrin qendror që e mbanë AUV konform këtij udhëzimi duhet të bëhet për qentë dhe macet me pronar.

Konform neni 5, paragrafi 1, në lidhje me neni 4, të Udhëzimit Administrativ për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese, identifikimi dhe regjistrimi i qenve dhe maceve me pronar, në regjistrin qendror duhet të bëhet çdo herë nën mbikqyrjen e AUV. Me neni 5, paragrafi 1, të këtij udhëzimi, është caktuar se zbatimi i identifikimit, pra vendosja e mikroçipit bëhet nga operatorët ekonomik të kontraktuar nga AUV dhe duhet t'i vendoset qenit dhe maces me pronar nga ana e veterinerëve të licencuar dhe të kontraktuar nga AUV.

Në neni 4, të Udhëzimit Administrativ për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese parashihet se kafshët shoqëruese identifikohen me mikroçip brenda 90 ditëve nga data e lindjes, ndërsa neni 15, paragrafi 1, i këtij udhëzimi e parasheh që të gjitha kafshët shoqëruese të cilat nuk janë identifikuar me mikroçip duhet të identifikohen në përputhje me këtë udhëzim.

Në UA 02/2021, që plotësoi UA 02/2018 – për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese, janë shtuar edhe përgjegjësitë e pronarit dhe obligueshmëria e pronarit që ta regjistrojë kafshën e tij shoqëruese dhe të jap edhe të dhënat e tij, në regjistrin qendror të AUV. Neni 4 i këtij udhëzimi, dhe nënpikat 1-6, përcaktojnë se kur, si dhe në çfarë kushte duhet të regjistrohen kafshët shoqëruese (qeni, macja) dhe si duhet të veprohet në rast të importit të ndonjë kafshe shoqëruese nga një shtet tjetër, në Kosovë.

10.4 AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E KOMUNAVE NË RAPORT ME KONTROLLIMIN DHE MENAXHIMIN E QENVE ENDACAK

Me nenin 13, të Ligjit për Veterinarinë janë të caktuara autorizimet dhe përgjegjësitë të cilat i kanë autoritetet komunale në raport me kontrollimin dhe menaxhimin e qenve endacak, të cilat autorizime dhe përgjegjësi duhet t'i ushtrojnë konform procedurave të vendosura nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Sipas nenit 13, paragrafi 1, pika (a), Autoritetet Komunale, janë përgjegjëse për regjistrimin e qenve. Pra, konform kësaj dispozite, Autoritetet Komunale kanë për detyrë që të bëjnë regjistrimin e qenve, pa marrë parasysh a janë qenë me pronar apo pa pronar.

Ndërsa, sipas nenit 13, paragrafi 1, pika (b), të Ligjit për Veterinarinë, Autoritetet Komunale kanë për detyrë që të bëjnë vaksinimin e qenve kundër tërbimit dhe dehelmentizimin kundër ekinokokëve. Neni 13, paragrafi 1, pika (c), e Ligjit për Veterinarinë, parasheh se Autoritetet Komunale janë të detyruara të bëjnë kapjen e qenve endacak dhe në rast nevojë të përdorin eutanazinë ndaj tyre, ndërsa sipas pikës (d) të këtij paragrafi, Autoritetet Komunale, në rast se përdorin eutanazinë, atëherë të njëjtit kanë për detyrë të bëjnë edhe largimin e trupave dhe hedhjen e tyre në një vend të sigurt. Detyrim tjetër i Autoriteteve Komunale në raport me kontrollimin dhe menaxhimin e qenve endacak është edhe detyrimi për themelimin e vendeve për përkujdesjen e qenve. Sipas nenit 13, paragrafi 1, pika (e), Autoritetet Komunale kanë për detyrë themelimin e vendeve për përkujdesje për qentë.

Ashtu siç është cekur edhe më lartë, autorizimet dhe përgjegjësitë e caktuara me nenin 13 të Ligjit për Veterinarinë, Autoritetet Komunale duhet t'i ushtrojnë konform procedurave të caktuara nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Duhet të potencohet që përveç Udhëzimit Administrativ për Kushtet Teknike të cilat duhet Plotësuar Qendrat e Trajtimit të Përkohshëm të Kafshëve Endacake, të cilin e ka nxjerrë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me të cilin ka obliguar komunat që të themelojnë qendra për trajtim të përkohshëm të kafshëve endacake, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nuk ka nxjerrë ndonjë udhëzim administrativ tjetër konform nenit 13, të Ligjit për Veterinarinë.⁴²

Është më rëndësi të potencohet se në vitin 2015, Komuna e Vushtrrisë, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale⁴³, ka nxjerrë Rregulloren për Kushtet e Mbajtjes së Qenve dhe Maceve dhe Mënyrën e Veprimit në Rast të Braktisjes ose Humbjes së Tyre.

42 Neni 2, paragrafi 3, i Udhëzimit Administrativ për Kushtet Teknike të cilat duhet Plotësuar Qendrat e Trajtimit të Përkohshëm të Kafshëve Endacake, parasheh që "Komunat janë të obliguara që të kenë qendër për trajtim të përkohshëm të kafshëve si dhe të sigurojnë vendin e veçantë për hedhjen e sigurt e trupave të kafshëve të ngordhura."

43 Në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht në nenin 17, të këtij ligji, parashihen kompetencat vetanake të komunës. Në nenin 17, paragrafi 1, pika (e), parashihet se komuna ka kompetencë që të kujdeset për mbrojtjen e mjedisit lokal, ndërsa në pikën (j) të këtij paragrafi, parashihet se komunat kanë kompetencë që të kujdesen për ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor, kurse pika (s) e këtij paragrafi parasheh se komuna është kompetente për çdo çështje tjetër që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është paracaktuar një autoriteti tjetër. Marrë për bazë faktin se çështja e kontrollimit dhe menaxhimit të qenve endacak, është çështje që pikë së pari ka të bëjë shëndetin publik, pasataj e njëjta hyn si çështje e mjedisit lokal, atëherë komunat konform këtyre dispozitave kanë për detyrë që të bëjnë kontrollimin dhe menaxhimin e qenve endacak.

Me nenin 16 dhe 17 të kësaj rregulloreje, është paraparë çështja e themelimit dhe funksionimit të strehimoreve. Neni 16, i kësaj rregulloreje përcakton se themelimi i strehimores duhet të kalojë përmes AUV, përkatësisht subjektet që themelojnë strehimore duhet të licencohen pranë AUV. Me nenin 17, të Rregullores për Kushtet e Mbajtjes së Qenve dhe Maceve dhe Mënyrën e Veprimit në Rast të Braktisjes ose Humbjes së Tyre, janë të rregulluara rastet se si të veprohet me qentë pa pronar. Sipas këtij neni, strehimoret të cilat operojnë brenda Komunës së Vushtrrisë, të themeluara konform legjislacionit në fuqi, duhet që secilën kafshë pa pronar ta marrin nën kujdesin e tyre, dhe të njëjtën pas trajtimit, (kastimit, sterilizimit, vaksinimit dhe vendosjes së mikroçipit) ta ofrojnë për adoptim për personat e interesuar. Me nenin 18 të Rregullores për Kushtet e Mbajtjes së Qenve dhe Maceve dhe Mënyrën e Veprimit në Rast të Braktisjes ose Humbjes së Tyre, parashihet se strehimoret e themeluara do t'i strehojnë qentë dhe macet si në vijim: 1). Qentë dhe macet e humbura deri në kthimin të mbajtësi i tyre; 2). Qentë dhe macet e braktisura, për të cilat nuk mund të vërtetohet identiteti i mbajtësit; 3). Qentë dhe macet për të cilat mbajtësi i tyre nuk mund të sigurojë kushtet e parapara për mbajtjen e tyre.

Duhet theksuar se me nenin 19 të Rregullores për Kushtet e Mbajtjes së Qenve dhe Maceve dhe Mënyrën e Veprimit në Rast të Braktisjes ose Humbjes së Tyre, është e rregulluar çështja e regjistrimit të qenve dhe maceve. Sipas kësaj dispozite, të gjithë mbajtësit e qenve apo maceve janë të detyruar që t'i regjistrojnë kafshët e tyre pranë qendrës së komunës për regjistrimin e kafshëve.

Në vitin 2015, Komuna e Deçanit ka nxjerrë Rregulloren për Kushtet e Mbajtjes së qenve si dhe Mënyrën e Veprimit në rast të Braktisjes ose Humbjes së tyre dhe Strehimorja e Qenve Endacak, me të cilën rregullore është e rregulluar edhe çështja e trajtimit të qenve të braktisur, të humbur dhe qenve endacakë. Në nenin 15 të kësaj rregulloreje parashihet që "Mbledhjen, transportin dhe akomodimin e qenve të braktisur dhe të humbur e bën kompania e autorizuar/kontraktuar nga Komuna". Ndërsa në nenin 17, 18 dhe 19 është e rregulluar çështja e themelimit të strehimoreve të qenve endacak. Sipas këtyre dispozitave, strehimorja e cila themelohet pasi ta ketë marrë licencën nga ana e AUV, duhet që për çdo qen të gjetur të bëjë njoftim publik, dhe të bëjë thirrje që të paraqitet mbajtësi i qenit. Nëse mbajtësi i qenit nuk paraqitet, atëherë strehimorja bën njoftim publik se qeni i gjetur është i gatshëm për adoptim. Pas gjetjes së qenit, strehimorja ka për detyrë që të bëjë trajtimin e qenit (kastimin, sterilizimin, vaksinimin dhe vendosjen e mikroçipit).

Pas analizimit të hollësishëm të legjislacionit të Republikës së Kosovës, mund të vijmë në përfundim që institucionet publike më kompetente për kontrollimin dhe menaxhimin e numrit të qenve endacak janë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe Autoritetet Komunale (Komunat). Këto institucione në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë rol në kontrollimin dhe menaxhimin e numrit të qenve endacak në Republikën e Kosovës.

Në bazë të analizës ligjore të bërë, mund të vihet në përfundim që ekziston infrastrukturë e mirë ligjore që institucionet relevante të kontrollojnë dhe menaxhojnë numrin e qenve endacak, mirëpo është e nevojshme që të nxjerrën edhe disa udhëzime administrative shtesë për këtë çështje, për nxjerrjen e të cilave është kompetente Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

04



*ZBATIMI I PROGRAMIT
TË MENAXHIMIT TË POPULLSISË
SË QENVE ENDACAK*

Kjo strategji, nëpërmjet programit të saj do të prezantohet në tri periudha të ndryshme të propozuara për zbatimin e PKGJ-së. Në periudhën e propozuar afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Për t'u zbatuar masat e propozuara në këtë strategji, masat do të paraqiten në Planin e Veprimit të PKGJ-ës duke u specifikuar përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshiera, afatet kohore dhe rezultatet e pritura nga zbatimi i masave.

11. PLANI I VEPRIMIT

Menaxhimi efektiv i popullsisë së qenve është një angazhim i përhershëm, me masat e përshkruara më lartë në pikën 9, por edhe masa të reja që evoluojnë me kalimin e kohës duke u bazuar në situatat aktuale dhe gjithmonë duke identifikuar burimet e problemit. Kjo kërkon një kombinim të veprimeve të një sistemi të qëndrueshëm qeverisës duke pasur mbështetje politike dhe shoqërore. Për ta zbatuar këtë strategji me PKGJ-ën dhe MMPQE-të duhet të parashihen katër komponente të rëndësishme zbatuese. dhe të cilat janë:

1) Legjislacioni dhe zbatimi;

Legjislacioni në lidhje me MMPQE ndodhet në dy nivele: legjislacioni qendror dhe komunal. Është më se e nevojshme që të propozohen ligje dhe akte nënligjore të reja dhe të përmirësohen dispozitat aktuale, për të siguruar bazë të qëndrueshme të zgjidhjes së problematikës së numrit të madh të qenve endacak në Kosovë. Megjithatë, pa zbatim të mirëfilltë, legjislacioni i propozuar apo përmirësuar, do të jetë jo efektiv.

Për t'u zbatuar kjo strategji dhe po ashtu për të gjetur zbatim të plotë të dispozitave ligjore në fuqi, duhet të angazhohen inspektorët veterinar apo të ndonjë fushe tjetër, që të inspektojnë çdo rast të mbajtjes së keqe të kafshëve, të shkruhen sa më shumë gjoba në mënyrë që pronarët të vetdijësohen mbi mbajtjen e përgjegjshme të kafshëve shoqëruese.

2) Grupi ndër-institucional komunal;

Në mënyrë që kjo strategji të jetë efektive dhe e qëndrueshme kërkon udhëheqje serioze nga një task forcë (grupi ndër-institucional komunal), për të drejtuar masat në planin afatgjatë drejt projekteve të rena dakord dhe përmes cikleve të menaxhimit adaptiv. Grupi në fjalë duhet të monitorojë gjithë procesin e zbatimit të strategjisë dhe masave të propozuara. Koordinimin e këtyre grupeve duhet ta bëjë Qeveria e Kosovës.

3) Qëndrueshmëria financiare dhe partneritetet

Në kontekstin e bashkëpunimeve ndër-shtetërore, Qeveria e Kosovës mund dhe duhet të kërkojë mbështetje financiare dhe në ekspertizë, nga shtetet e tjera të interesuara të ndihmojnë në menaxhimin e popullsisë së qenve endacak në Kosovë. Kjo ndihmë mund të ofrohet drejtpërdrejtë nga qeveritë e huaja apo nga autoritete të ndryshme qofshin ato të specializuara në ndihmë ndërkombëtare apo në menaxhimin e popullsisë së qenve endacak, gjithmonë duke marrë për bazë praktikrat e implementuara në shtetet amë.

4) Angazhimi i komunitetit

Angazhimi i Komunitetit është një proces i rëndësishëm për ndërtimin e marrëdhënieve midis njerëzve që kanë një rol ose interes në përmirësimin e situatës së qenve në komunitetin e tyre dhe institucioneve shtetërore që janë të mandatuara ta mbrojnë shëndetin e kafshëve dhe të njerëzve.

Qytetarët duhet të bashkëpunojnë si komunitet për të vlerësuar popullsinë e qenve dhe për të hartuar dhe zbatuar një sistem të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në nivel lokal.

11.1 PLANI I VEPRIMIT DHE MONITORIMI I PROGRAMIT

Nr.	Masat e propozuara	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Rezultatet e pritura	Objektivat/Fushat e ndërhyrjes	Masat për zbatim	Indikatorët kryesor të performancës
A							
NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET LIGJORE							
1 Përpilimi i Udhëzimit Administrativ për kontrollin dhe licencimin e mbarështuesve të kafshëve shoqëruese							
1.1.	Të rishikohet dhe aprovohet nga grupi punues i MBPZHR	MBPZHR, AUV, OSHC-të	2021 ASH	Aprovimi dhe hyrja në fuqi e udhëzimit administrativ për kontrollin dhe licencimin e mbarështuesve të kafshëve shoqëruese	Kontrolli i mbarështuesve të kafshëve shoqëruese për të parandaluar mbarështimin e pakontrolluar dhe të pa licencuar	Angazhim institucional dhe resurset e nevojshme (njerëzore dhe financiare)	UA është nënshkruar nga Ministri i MBPZHR dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare
2 Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 04/2017 për Kushtet Teknike të cilat duhet Plotësuar Qendrat për Trajtim të Përkohshëm të Kafshëve Endacake							
2.1	Krijimi i grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e UA (MBPZHR) 04/2017	MBPZHR, AUV, OSHC-të	2021 ASH	Ndryshimi dhe plotësimi i disa neneve të UA për projekte më efektive të KSVL	Mirëqenie më e mirë e kafshëve endacake në QTP-të për projektet e KSVL-së	Angazhim institucional dhe resurset e nevojshme njerëzore (grupi punues)	Ndryshimet dhe plotësimet e UA janë nënshkruar nga ministri i MBPZHR
3 Përpilimi i Udhëzimit Administrativ për mbajtje të përgjegjshme të kafshëve shoqëruese							
3.1.	Krijimi i grupit punues për përpilimin e Udhëzimit Administrativ	MBPZHR, AUV, OSHC-të	2021 ASH	Aprovimi dhe hyrja në fuqi e UA për mbajtje të kafshëve shoqëruese	Përcaktimi i kushteve dhe obligimeve për mbajtje të kafshëve, bazuar në parimet e Pesë Lirive ⁴⁴	Angazhimi i resurseve njerëzore në institucionet përgjegjëse	UA është nënshkruar nga ministri i MBPZHR dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare
4 Përpilimi i Udhëzimit Administrativ për strehimoret dhe qendrat e shpëtimit							
4.1	Krijimi i grupit punues për përpilimin e Udhëzimit Administrativ	MBPZHR, AUVK, OSCH-të	2022 ASH	Sistematizimi i konceptit të strehimoreve dhe qendrave të shpëtimit	Krijimi i strehimoreve funksionale që respektojnë rregullat e mbajtjes së kafshëve	Angazhim institucional dhe resurset e nevojshme (njerëzore dhe financiare)	UA është nënshkruar nga ministri i MBPZHR dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare
B							
IMPLEMENTIMI I LIGJEVE DHE AKTEVE TJERA NËNLIGJORE							
1 Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve shoqëruese sipas UA (MBPZHR) 02/2018 & 02/2021							
1.1.	Blerja e 10,000 mikroçipëve me kod kombëtar të Kosovës dhe fillimi i regjistrimit të qenve me pronar	MBPZHR, AUV	2021 ASH	Fillimi i regjistrimit të qenve me pronar dhe regjistrimi i vet pronarëve	Parandalimi i braktisjes së qenve në pronësi, kontrolli më i rreptë i dinamikës së qenve në pronësi dhe parandalimi i përhapjes së sëmundjeve zoonotike	Planifikimi dhe alokimi i buxhetit, dhe kontraktimi i vazhdueshëm i veterinerëve	5,000 qen të regjistruar me mikroçip deri në vitin 2023 dhe 20,000 qen të regjistruar deri në vitin 2026

44 https://www.aspc.org/sites/default/files/upload/images/aspc_a_sv_five_freedoms_final1.ashx_.pdf

Nr.	Masat e propozuara	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Rezultatet e pritura	Objektivat/Fushat e ndërhyrjes	Masat për zbatim	Indikatorët kryesor të performancës
1.2.	Kontraktimi i vazhdueshëm i subjekteve veterinarë për regjistrimin e kafshëve shoqëruese	AUV	2021 ASH	Fillimi i regjistrimit të qenve dhe pronarëve të tyre në regjistër shtetëror	Shmangja e projekteve gjysmë dhe sigurimi i kontinuitetit të zbatimit të UA 02/2018 dhe 02/2021	Planifikim buxhetor dhe kontraktim i operatorëve ekonomik	Subjekte veterinarë aktive për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve shoqëruese
1.3.	Angazhimi i inspektorëve veterinarë dhe Policisë së Kosovës	AUV, Policia e Kosovës (MPB), Komunitat	2021 ASH	Fillimi i kontrollimit dhe inspektimit të regjistrimit të qenve si kafshë shoqëruese	Të regjistrohen me sukses qentë si kafshë shoqëruese dhe të bëhet inspektimi në hapësira publike i qenve me pronar	Angazhimi i resurseve njerëzore në institucionet përgjegjëse	Gjobitja e personave që nuk i kanë regjistruar qentë e tyre
1.4.	Sigurimi i skanerëve/lexuesve të mikroçipëve të kafshëve shoqëruese	AUV, MBPZHR	2021-2022 ASH	Planifikim buxhetor për blerjen e skanerëve/lexuesve të mikroçipëve	Pajisja e inspektorëve dhe policisë me të gjitha mjetet e nevojshme për inspektim	Planifikim buxhetor	Lexuesit e mikroçipëve janë dorëzuar tek policia dhe inspektorët
2	Zbatimi i Udhëzimit Administrativ për mbajtje të përgjegjshme të kafshëve shoqëruese						
2.1.	Angazhimi dhe trajnimi i inspektorëve për mbrojtje të kafshëve shoqëruese	MBPZHR, AUV, OSHC-të	2022-2023 AM	Specializimi i inspektorëve për inspektim dhe monitorim të mirëqenies së kafshëve shoqëruese	Inspektorë aktiv dhe profesional në inspektimin e kushteve të mbajtjes së kafshëve shoqëruese	Angazhimi i resurseve njerëzore në institucionet përgjegjëse	Së paku 70% e inspektorëve të trajnuar në mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve shoqëruese
2.2.	Trajnimi i stafit të Policisë	Akademia e Kosovës për Siguri Publike, AUV, OSHC-të	2022-2023 AM	Informimi dhe trajnimi i zyrtarëve policorë për mbrojtjen e kafshëve dhe për respektimin e akteve ligjore në lidhje me mbrojtjen e kafshëve	Zyrtarë policorë të trajnuar dhe të dedikuar për zgjidhjen e problemeve me ose drejt kafshëve shoqëruese	Angazhimi i resurseve njerëzore dhe planifikim buxhetor	Së paku 30% të zyrtarëve policorë të trajnuar në mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve shoqëruese
2.3.	Trajnime obligative për pronarët e kafshëve shoqëruese (20-30 orë trajnim)	MBPZHR, AUV, OSHC-të, Operatorët ekonomik	2022-2023 AM	Obligim ligjor për pronarët e kafshëve shoqëruese për të parandaluar braktisjet dhe mbajtjen e pa-përgjegjshme	Pronarë më të përgjegjshëm dhe më pak braktisje dhe keqtrajtime të qenve	Planifikim buxhetor dhe ndryshime ligjore	Deri në fund të 2023, të gjithë pronarët e kafshëve e kanë kryer trajnimin për mbajtje të përgjegjshme të kafshëve shoqëruese
3	Zbatimi i Udhëzimit Administrativ për Strehimoret dhe Qendrat e Shpëtimit						
3.1.	Angazhimi i inspektorëve për inspektimin e strehimoreve dhe qendrave të shpëtimit	AUV, Komunitat	2022-2023 AM	Angazhimi i inspektorëve për zbatimin e akteve ligjore	Përmirësimi i inspektimeve të strehimoreve, për të siguruar mirëqenien e kafshëve dhe njerëzve	Ndryshimi i akteve nënligjore, resurse njerëzore dhe planifikim buxhetor	Raport i detajuar i AUV dhe MBPZHR në lidhje me situatën e strehimoreve në Kosovë

Nr.	Masat e propozuara	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Rezultatet e pritura	Objektivat/Fushat e ndërhyrjes	Masat për zbatim	Indikatorët kryesor të performancës
3.2.	Subvencionimi i strehimoreve që plotësojnë kushtet dhe transformimi i tyre në qendra të shpëtimit për rastet emergjente	MBPZHR, AUV, Komunitat	2022-2023 AM	Funksionalizimi dhe sistematizimi i strehimoreve aktuale dhe të reja për shpëtimin dhe trajtimin e qenve të rrugës. Poashtu, strehimi i qenve agresiv dhe të braktisur.	Parandalimi i shtimit të qenve në rrugë për shkak të braktisjeve dhe strehimore aktive për raste emergjente dhe krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të adoptimeve	Planifikim dhe alokim buxhetor	Strehimore dhe qendra aktive të shpëtimit që respektojnë në plotësi mirëqenien e kafshëve, janë të qëndrueshme dhe kanë programe të adoptimit
4	Krijimi i grupit ndër-institucional						
4.1.	Vendimi për krijimin e grupit ndër-institucional për menaxhimin e popullsisë së qenve endacak	ZKM, MBPZHR, MAPL, AUV, Komunitat	2021-2022 ASH	Të krijohet grupi punues me të gjithë akterët e nevojshëm, për të koordinuar dhe monitoruar veprimet për menaxhimin e popullsisë së qenve endacak	Angazhim serioz dhe të vazhdueshme për implementimin e masave për menaxhimin e popullsisë së qenve endacak	Angazhim institucional, resurse njerëzore dhe planifikim buxhetor	Vendim zyrtar për krijimin e grupit ndër-institucional
C	KONTROLLI I MBARËSHTIMIT DHE SHITJES SË QENVE						
1	Kontrolli i mbarështuesve						
1.1.	Kontrolla strikte nga AUV të mbarështuesve të kafshëve shoqëruese dhe qendrave mbarështuese	AUV, Inspektorët, Komunitat	2021 ASH	Kontrolli efektiv i qenve të mbarështuar, shitur ose importuar në Kosovë. Të parandalohet mbarështimi i pakontrolluar dhe braktisjet e shumta që bëhen nga vetë mbarështuesit	Krijimi i një sistemi serioz shtetëror për kontrollin e dinamikës së popullsisë së qenve	Angazhimi inspektorëve dhe planifikimi buxhetor	Mbyllja e qendrave ilegale të mbarështimit dhe sanksionimi i mbarështuesve ilegal
1.2.	Krijimi i qendrave të shpëtimit për qentë e konfiskuar nga qendrat mbarështuese	MBPZHR, AUV, Komunitat	2022-2025 AGJ	Të ketë infrastrukturë për akomodimin e kafshëve shoqëruese të konfiskuara	Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të strehimit të kafshëve të konfiskuara	Planifikim buxhetor dhe angazhim institucional	Qendra funksionale të shpëtimit të kafshëve të konfiskuara në të gjithë Kosovën

Nr.	Masat e propozuara	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Rezultatet e pritura	Objektivat/Fushat e ndërhyrjes	Masat për zbatim	Indikatorët kryesor të performancës
D	EDUKIMI NË SHKOLLA DHE VETDIJËSIMI I SHOQËRISË						
1	Vetëdijësimi i shoqërisë						
1.1.	Organizimi i kampanjave informuese përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit (TV, Radio, rrjetet sociale, ekspozitat etj.)	MBPZHR, AUV, Komunitat, OSHC-të	2022 e tutje	Të ketë informata të vazhdueshme për njerëzit që kanë ose planifikojnë të mbajnë kafshë shoqëruese	Ngritja e vetëdijës së komunitetit të njerëzve që mbajnë kafshë shoqëruese dhe të ulen braktisjet në rrugë	Ndarje e buxhetit dhe angazhim i resurseve njerëzore	Sondazhet me qytetarë për mirëqenien e kafshëve dhe braktisjet
1.1.1	Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve shoqëruese sipas UA (MBPZHR) 02/2018 dhe UA (MBPZHR) 02/2021	MBPZHR, AUV, Komunitat, OSHC-të	2022 e tutje	Pronarë më të informuar për obligimet ligjore për regjistrimin e qenve	Ngritja e vetëdijës për identifikimin dhe regjistrimin e qenve përmes mikropipit në nivel shtetëror		Sondazh i pronarëve të qenve për obligimet e tyre për regjistrimin e qenve
1.1.2	Mbajtja e përgjegjshme e qenve	MBPZHR, AUV, Komunitat, OSHC-të	2022 e tutje	Pronarë më të informuar për mbajtje të përgjegjshme që respekton në plotësi mirëqenien e kafshëve	Kampanja informuese të vazhdueshme dhe të strukturuar për pronarët aktual dhe të ardhshëm të qenve		Sondazh i pronarëve të qenve për mbajtje të përgjegjshme, inspektime për mbajtje të përgjegjshme
1.1.3	Benefitet e sterilizimit të qenve endacak dhe atyre me pronar	MBPZHR, AUV, Komunitat, OSHC-të	2022 e tutje	Komunitet (përfshirë edhe pronarët e qenve) më të informuar për benefitet e sterilizimit	Hedhja poshtë e miteve për sterilizim dhe informimi korrekt i njerëzve për benefitet e sterilizimit		Së paku 1000 qen me pronar të sterilizuar në tre-mujorin e dytë të 2022
1.1.4	Sjelljet e qenve dhe natyra e tyre	MBPZHR, AUV, Komunitat, OSHC-të	2022 e tutje	Komunitet më të informuar për sjelljet dhe karakteristikat e qenve	Hedhja poshtë e miteve se qentë janë të rrezikshëm dhe të papastër		Sondazh me qytetarët për sjelljet e qenve, më pak raste të kafshimit
2	Edukimi në shkollë						
2.1.	Organizimi i ligjeratave/aktiviteteve në shkollat fillore dhe të mesme për mirëqenien e kafshëve dhe mbajtjen e përgjegjshme të tyre	MASHTI, Komunitat, OSHC-të	2021-2023 AM	Të edukohen gjeneratat e reja mbi mbajtjen e përgjegjshme të kafshëve dhe mirëqenien e tyre	Të evitohen blerje të pa planifikuara të kafshëve shoqëruese dhe braktisjet e shumta nga mos informimi i duhur për qentë si kafshë shoqëruese	Planifikim buxhetor dhe angazhim i resurseve njerëzore	Së paku 1000 ligjerata të organizuara deri në fund të vitit shkollor 2022/2023 kurse të paktën 15000 ligjerata, deri në 2026

Nr.	Masat e propozuara	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Rezultatet e pritura	Objektivat/Fushat e ndërhyrjes	Masat për zbatim	Indikatorët kryesor të performancës
2.2.	Përfshirja e mirëqenies së kafshëve në kurrikulat shkollore	MASHTI, Komunitat, OSHC-të	2023-2026 AGJ	Edukimi i vazhdueshëm për mirëqenien e kafshëve	Formalizimi i mësimëve shkollore dhe ndryshimi i kurrikulave shkollore	Planifikim buxhetor dhe angazhim institucional	Mirëqenia e kafshëve është përfshirë në kurrikulat shkollore
E	SUBVENCIONIMI I KASTRIMIT DHE STERILIZIMIT TË QENVE ME PRONAR						
1	Kastrimi dhe sterilizimi i qenve me pronar						
1.1.	Kontraktimi i veterinerëve për trajtimin e kafshëve të vogla	MBPZHR, AUV, Komunitat, OSHC-të	2022 ASH	Sterilizimi i qenve si kafshë shoqëruese për të ndihmuar në reduktimin e mbarështimeve të paplanifikuara	Parandalimi i mbarështimeve aksidentale dhe të padëshiruara të qenve	Planifikim buxhetor	Së paku një subjekt veterinar i kontraktuar për çdo komunë në mënyrë të vazhdueshme
1.2.	Organizimi i kampanjave informuese për kastrim dhe sterilizim falas të qenve me pronar	MBPZHR, AUV, Komunitat, OSHC-të	2022-2023 SHT	Informimi i pronarëve të qenve për benefitet e sterilizimit dhe ofrimin pa pagesë të këtij shërbimi	Edukimi i pronarëve të qenve për të sterilizuar qentë e tyre	Planifikim buxhetor dhe angazhim institucional	Numër në rritje i qenve të sterilizuar me pronar
F	PROJEKTET E KSVL-së PËR KONTROLL TË RIPRODHIMIT TË QENVE ENDACAK						
1	Evalumi i veterinerëve për proceset e KSVL-së						
1.1.	Trajnime periodike për veterinerët në fushën e kirurgjisë së kafshëve të vogla	AUV, Shoqatat Veterinare, Fakulteti i Veterinarisë, OSHC-të	2022-2023 AGJ	Trajnimi i veterinerëve të papërvuajës në kastrim dhe sterilizim të kafshëve të vogla	Të mos përfshihen në projekte të KSVL veterinerë të papërvuajës dhe pa përgatitje profesionale në trajtimin e kafshëve të vogla	Planifikim buxhetor dhe angazhim institucional	Së paku 4 trajnime/seminare të organizuara gjatë vitit
1.2.	Ndarja e licencimeve të veterinerëve (të specializuar në kafshë të vogla dhe të mëdha)	MBPZHR, AUV, Fakulteti i Veterinarisë	2022-2026 AGJ	Të caktohen dhe specializohen veterinerët sipas përvojës në fushë të caktuar dhe të mos operojnë në kafshë të vogla pa qenë të specializuar	Parandalimi i rrezikimit të mirëqenies së kafshëve dhe ndërtimi i kapaciteteve profesionale veterinarë përmes specializimeve	Angazhim i resurseve njerëzore dhe institucionale	Drejtimi i ri për specializim për kafshët e vogla është aprovuar dhe është përfshirë në Fakultetin e Veterinarisë
2	Tenderimi i vazhdueshëm i projekteve të KSVL-së njëtrajtshëm nga të gjitha Komunitat						
2.1.	Kontraktimi i veterinerëve të trajnuar dhe me përvojë në trajtimin e kafshëve të vogla në të gjitha komunitat	AUV, Komunitat	2022-2023 ASH	Të ketë projekte të vazhdueshme dhe të qëndrueshme për kastrimin dhe sterilizimin e qenve endacak	Më pak qen të pasterilizuar në rrugë - më pak shumime të qenve në rrugë	Alokim buxhetor dhe kontraktim i operatorëve ekonomik	Projekte aktive të vazhdueshme të KSVL -së në të gjitha komunitat

Nr.	Masat e propozuara	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Rezultatet e pritura	Objektivat/Fushat e ndërhyrjes	Masat për zbatim	Indikatorët kryesor të performancës
3	Gropat septike për asgjësim të sigurt të kafshëve të vdekura						
3.1	Alokimi i hapësirave në të gjitha komunat për asgjësimin e sigurt të kafshëve të vdekura	Komunat	2021 e tutje	Shëndet publik më i mirë	Asnjë kafshë e vdekur në hapësirat publike ku rrezikohet shëndeti publik	Planifikim buxhetor, monitorim dhe menaxhimi i duhur i komunave për implementim të projekteve	Gropa septike në të gjitha komunat
KONTROLLI I QASJES NË RESURSE							
1	Kontrolli i lëvizjes së qenve endacak përmes kontrollit të qasjes në resurse						
1.1.	Pikat me ushqim dhe ujë për qentë endacak	Komunat	2022 ASH	Krijimi i pikave për ushqim dhe ujë për qentë endacak në të gjitha komunat, larg zonave të banimit	Krijimi i një strukture për përkujdesje të kafshëve endacake në mungesë të strehimit të mirëfilltë	Planifikim buxhetor	Së paku 25 pika për ushqim dhe ujë në secilën komunë
1.2.	Grumbullimi i rregullt i mbeturinave	Komunat	2021 ASH	Parandalimi i prezencës së madhe të qenve në afërsi të restoranteve, shkollave, çerdheve dhe shportave të mbeturinave	Krijimi i një strukture për përkujdesje të kafshëve endacake në mungesë të strehimit të mirëfilltë, dhe rrjedhimisht mjedis më i pastër	Planifikim buxhetor dhe angazhim i stafit shtesë për grumbullim të mbeturinave	Hapësira më të pastërta publike
E	KUJDESTARËT E LAGJES PËR KAFSHËT ENDACAKE						
1	Vendosja e kujdestarëve të lagjes për kafshët endacake						
1.1.	Vendimi për themelimin e kujdestarëve të lagjes për kafshët endacake dhe kompetencat e tyre	MBPZHR, MAPL, Komunat	2022-2023 AM	Monitorimi i numrit të qenve endacak dhe gjendjen e tyre në komunitet. Më shumë siguri publike dhe kujdes më i madh për qentë e rrugës	Krijimi i një qasje institucionale për monitorimin dhe menaxhimin e qenve të rrugës në lagjet e Kosovës	Angazhim i resurseve njerëzore dhe planifikim buxhetor	Vendimi është nënshkruar nga secila komunë deri në fund të vitit 2023
1.2.	Subvencionimi dhe punësimi i kujdestarëve të lagjes	MBPZHR, MAPL, Komunat	2022-2024 ASH	Angazhimi i individëve në kapacitetin e kujdestarëve të lagjes për kafshët endacake në të gjitha komunat për të menaxhuar popullsinë e qenve endacak	Krijimi i një strukture të qëndrueshme të kujdesit për kafshët e rrugës në mungesë të strehimit adekuat	Angazhim i resurseve njerëzore dhe planifikim buxhetor	Kujdestarët e lagjes janë punësuar në çdo komunë

MIRËNJOHJET

Mirënjohja jonë shkon për të gjithë ata që dhanë njohuri dhe mbështetje të vlefshme për hartimin e kësaj strategjie. Jemi të bindur se kjo strategji do të ofrojë udhëzimet e duhura për të përmirësuar jetën e mijëra qenve dhe njerëzve në Republikën e Kosovës.

Kjo strategji është bazuar tërësisht në udhëzimet e "World Animal Protection" dhe "ICAM Coalition". Udhëzimet dhe metodologjia e tyre kanë qenë jashtëzakonisht të dobishme për përpilimin e kësaj strategjie dhe përshtatjen e saj me situatën me qentë endacak në Kosovë.

Gjithashtu do të donim të falënderonim partnerët e organizatës, të cilët me përkushtim dhe profesionalizëm, kanë rishikuar, komentuar dhe sugjeruar propozime të rëndësishme për të kompletuar këtë strategji me sukses. E falënderojmë shumë, znj. Helen Wormser, drejtoreshë e Fondacionit "StrayCoCo", për mbështetjen e saj të madhe dhe idetë e propozuara për këtë strategji. StrayCoCo gjithashtu ka bërë një punë të shkëlqyeshme me projektet e KSVL-së në Kosovë për shumë vite deri më tani, me standardet më të larta, duke ndihmuar me mijëra qen endacak në Kosovë.

Gjithashtu, njëra nga organizatat e cila e ka mbështetur FDK-në, sidomos në fushën e rishikimit të akteve ligjore e nënligjore, është edhe organizata nga Zvicra, TIR.

Mirënjohjet tona shkojnë edhe për Fondacionin "Stumme Brueder" nga Lihtenshtajni dhe "LAV" dhe "ATB" nga Italia, për mbështetjen e vazhdueshme dhe këshillat profesionale për 'Fondacionin për të Drejtat e Kafshëve' në Kosovë që nga themelimi i tij. Do të donim të falënderonim PETA Germany dhe donatorin z. Benito Mares, për mbështetjen e FDK -së dhe besimin e tyre, në misionin dhe vizionin tonë për të mbrojtur kafshët në Kosovë.

Për fund, do të donim të falënderonim vullnetarët e organizatës tonë dhe të gjithë aktivistët për mbrojtjen e kafshëve, për ndihmën e vazhdueshme që japin për kafshët endacake në Kosovë.

*"Madhështia e një kombi dhe progresi moral i tij
mund të gjykohen nga mënyra se si trajtohen kafshët e atij kombi."*

Mahatma Gandhi



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve
www.animalrights-rks.org